

**UNITED
NATIONS**
United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 27 dhe 28 KORRIK 2006**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 27 I 28 JULA 2006 GODINE**

KORRIK – JULI 2006

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
3. Pyetjet e deputetëve për Qeverinë e Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trashëgimin kulturore.
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit Nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë.
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat e lira industriale.
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parqet nacionale.
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Ushqim,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin e gjuhëve
10. Shqyrtimi i propozimeve nga G/P për emërimin e anëtarit në Këshillin e KPM-së
11. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e kryesuesit të Bordit të Rregullatorit të Energjisë,
12. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e z. Alaty Suroy , zvendës ministër të Drejtësisë,
13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Ekonomi, Industri, Energjetikë, Miniera, Transport e Telekominacion. Lidhur me raportin e ART-së për punën një vjeçare 2005,

DNEVNI RED

1. Usvajanje dnevnog reda,
2. Usvajanje zapisnika sa prošle sednice,
3. Poslanička pitanja za Vladu Kosova,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o kulturnom nadsledstvu
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni Zakona bar. 2004/5 za trgovinu naftom i naftnim derivatima na Kosovu
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o slobodnim industrijskim zonama.
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o nacionalnim parkovima
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o hrani.
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona o upotrebi jezika
10. Razmatranje predloga iz P/G o imenovanju člana u PSM-u
11. Razmatranje predloga Vlade o imenovanju predsedavajućeg Borda Regulatora energije.
12. Razmatranje predloga Vlade u imenovanju zamenika ministara Pravde Altay Suroy
13. Razmatranje Izveštaja Komisije za privredu, industriju, energetiku, rudnike, transport i telekomunikacije, u vezi sa Izveštajem RAT-a o jednogodišnjem radu – 2005. godinu .

AGENDA

1. Approving the agenda,
2. Approving the minutes from the previous session,
3. Questions of deputies for the Government of Kosova,
4. First reading of the Draft law on Cultural Heritage
5. First reading of the Draft law on changing the law Nr. 2004/5 for trade of petroleum and petroleum products in Kosova.
6. First reading of the Draft law on the free industrial zones.
7. First reading of the Draft law on national parks.
8. Second reading of the Draft law on food.
9. Second reading of the draft law on language use
10. Studying the proposals made by the PG (Parliamentary Group) for appointing the member for the Council of the IMC
11. Studying the proposal made by the Government for appointing the chair of the Energy Regulatory Board,
12. Studying the proposals made by the Government for appointing the deputy minister of Justice Altay Suroy.
13. Communication concerning the report made by RAT (Regulatory Authority for Tele-Communication) for the one year work 2005.

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës u mbajt më 27 dhe 28 korrik 2006

Seanca ia filloi punës në orën 10

Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha
Kryesuesi Sabri Hamiti

KRYESUESI SABRI HAMITI – Kolegë të respektuar deputetë, anëtarë të kabinetit qeveritar, mirë se vini në seancën e Kuvendit të Kosovës. Ju njoftoj se të pranishëm janë 79 deputetë, që do të thotë se mund t'ia fillojmë punës. Jua sjell ndërmend që rendin e ditës të miratuar nga Kryesia dhe nga konsultimet me grupet parlamentare e keni marrë me kohë. Gjithashtu edhe materialet shoqëruese për temat që do të shqyrtohen në këtë seancë të Kuvendit të Kosovës. Fjalën e kërkon Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryesues. Ju faleminderit për dërgim të materialeve të plota me kohë. Ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar këtë rend dite si dhe kemi mirëpritur përmbajtjen e tij. Me një vendim të pikës 8 të rendit të ditës që ka të bëjë me Ligjin për ushqimin, kërkojmë që t'u jepet kohë Komisionit Funkcional si dhe Komisionit për Shëndetësi për përpjekje të harmonizimit të dy grupeve plotësisht të ndryshme të amendamenteve që i ofrohen kësaj seance. Po ashtu e mbështesim kërkesën e Komisionit Funkcional që Projektligji për zonat industriale të jetë në rishqyrtim në Qeveri dhe të vijë një tekst tjetër. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. Gashi. Fjalën e ka Gjylnaze Syla

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit. I nderuari z. kryesues, zëvendëskryeministër, ministra, deputetë të nderuar. Unë kam një vërejtje lidhur me rendin e ditës. Dy kërkesat e Grupit Parlamentar të Aleancës që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimit dhe me propozimin e Projektrezolutës lidhur me diasporën i kanë përmbushur të gjitha kërkesat e caktuara me Rregulloren e punës së Kuvendit të Kosovës. Në Rregullën 6, që ka të bëjë me detyrat e Kryesisë, pika 5 qëndron se kur një grup parlamentar kërkon që një çështje të vihet në rend të ditës, ajo çështje vihet në rend të ditës brenda periudhës prej tri javësh, kurse seanca e debaton. Pra, duke u bazuar në këtë rregull kërkoj të vihen në rend të ditës kërkesat e Grupit Parlamentar meqë janë përmbushur të gjitha kushtet për t'u vënë në rend të ditës. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Të merremi vesh para se ta marrë fjalën Jakupi, që të mos i ngatërrojme çështjet. Kishim një propozim të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të grupit të saj parlamentar që pika e 8, -Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin për arsyet që i tha kryetari i Grupit Parlamentar të hiqet sot nga rendi i ditës. Ju lutem, kush është për këtë? Shumica. Kush është kundër? S'ka kundër. Abstenim nuk ka. Pika e 8 e rendit të ditës hiqet.

Propozimi i dytë vjen nga kryetarja e Grupit Parlamentar,
Kush kishte propozim për pikën 6, mirëpo s'kishim arsyetim. Alushi e tha që e përkrah atë ide, por nuk e di se kush e arsyeton. Sido që të jetë kërkesa e Grupit Parlamentar

njëherit edhe e LDK-së është të hiqet nga rendi i ditës. Siç mora vesh. në marrëveshje me Ministrinë përkatëse- propozuese edhe pika e 6-të e rendit të ditës, Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat e lira industriale. Ju lutem kush është për këtë propozim?

Për shumica
Kundër nuk ka votë kundër,
Abstenim nuk ka .

Votohet që të hiqet edhe pika 6 e rendit të ditës.

E kemi edhe propozimin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës lidhur me një rezolute të propozuar për Parlamentin. Unë diçka tjetër këtu nuk mund të shtoj, por nuk mund të informoj se Kryesia e ka trajtuar këtë problem dhe nuk e ka vënë në rend të ditës për sot për seancën .Shpjegim tjetër nuk jam në gjendje të jap dhe nuk kam pse të jap. Kryesia e ka trajtuar problemin në mbledhjen e vet të fundit dhe nuk e ka vënë në rend të ditës me arsyetimin që për atë tekst duhet të bisedohet me grupet e tjera parlamentare me një sugjerim që pika e parë e tij është më e rëndësishmja që t'i rekomandohet Qeverisë të nxjerrë ligj për diasporën. Kjo është në pika të shkurtra , më esenciale që kam të them sot.
Fjalën e kërkon Gjylnaze Sylja.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryesues. Unë thashë se sipas rregullave në fuqi me të cilat jemi pajtuar të gjithë në Kuvend ,kur një grup parlamentar kërkon të vihet në rend të ditës ai mocion përmbajtjesor vihet në rend të ditës brenda 3 javësh, d.m.th . Kryesia nuk mund të vendos se a duhet të debatojë , përndryshe nuk do të kishte grupe parlamentare, kishte për të vendosur Kryesia për të gjitha, me rregullat në fuqi pasi është plotësuar kriteri 3 javë kërkesat e grupit parlamentar për Kushtetutën dhe për projektrezolutën për diasporën duhet të jenë sot në rend të ditës. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Z. Sylja ju faleminderit për interpretim të Rregullores, e di edhe unë sa ti atë rregullore. Unë po ju them se Kryesia e ka shqyrtuar,por grupet e tjera parlamentare nuk e kanë bërë këtë,kurse unë çka mund të bëj do të bëj tash . Ju lutem kush është që të hyjë në rend dite problemi i një rezolute që nuk e keni në dorë ju as askush tjetër dhe nuk ka objekt diskutimi. Unë formalisht do ta hedh në votë këtë problem, kush është për propozimin e zonjës që të hyj në rend të ditës ky problem sot? S'ka kundër Gjylnaze. Kalojmë tutje.

Fjalën e ka z. Jakup Krasniqi, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryesues, të nderuar deputetë, Grupi Parlamentar i PDK-së ka marrë rendin e ditës dhe ne e kemi një propozim që pika e 13-të të hiqet nga rendi i ditës, Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Ekonomi, Industri, Energjetikë, Miniera, Transport e Telekomunikacion, lidhur me raportin e ART-së për punën njëvjeçare 2005. Ne kërkojmë që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës për faktin se ne nuk duhet të merremi me raportin e Komisionit, por duhet të merremi me raportin e ART-së dhe sipas ligjit shefi i ART-së është i obliguar t'i raportojë një herë Kuvendit për punën e tij. Nën një, nën dy, gjendja në telefoninë mobile është e tillë që neve na obligon në një formë të kemi njohuri më të plota se vërtet nga drejtuesi i ART-së për të na treguar se si është gjendja në telefoninë mobile në Kosovë, cilat janë vështirësitë dhe problemet dhe

pastaj kjo pikë e rendit të ditës të hyjë në një mbledhje, por raporti të jetë i ART-së dhe shefi i ART-së t'i raportojë Kuvendit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Fjalën e ka Alush Gashi

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryesues. Mendoj se propozimi i opozitës vetëm i begaton debatin, raportin dhe si të tillë ne e mirëpresim për një seancë të ardhshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – E hedh në votim propozimin e z. Krasniqi, të përkrahur edhe nga LDK-ja që pika 13 për raportin e Komisionit rreth ART-së të hiqet nga rendi i ditës. Kush është për? Ju faleminderit. A ka kundër? Nuk shoh votë kundër. Pra hiqet pika 13 e rendit të ditës.
Për fjalë është paraqitur Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Faleminderit z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë, e nderuara Qeveri. Mendoj se në këtë mbledhje në një farë mënyre supozohet se kjo do të jetë mbledhja e fundit para pushimeve të pushpallura në një farë mënyre, vetëm në fund të gushtit mund të kemi mbledhje tjetër. Është dashur që në një farë mënyre Delegacioni i Umitetit të vijë dhe t'i raportojë Kuvendit që ta ketë informacionin zyrtar lidhur me punën që është bërë në Vjenë. Siç e dini të gjithë ne ia kemi dhënë mandatin atij delegacioni dhe ai delegacion ka udhëtuar atje me mandatin e këtij Kuvendi. Ka qenë raportim pas takimit të parë në Kuvend. me të cilin nuk kemi qenë të gjithë të kënaqur. me mënyrën si është përgatitur dhe si është realizuar, por ka qenë e udhës që edhe në këtë seancë ta kemi një raportim nga ana e kryetarit të Kosovës dhe nga tërë Delegacioni, sepse çështjet që janë diskutuar atje janë çështje shumë me rëndësi dhe ne si përfaqësues të popullit sigurisht do të duhej të kemi informacion më të madh, se sa informacion nga anëtarët tonë, nga krahu ynë që është anëtar i atij grupi edhe brenda grupit janë dakorduar që në Kuvend të vihet dhe të raportohet. Pse nuk është përfshirë në rend të ditës nuk e kam të qartë, prandaj propozoj të përfshihet në rend të ditës, të merret pauzë për sa kohë ka nevojë dhe që kryetari dhe grupi të vijë dhe të na raportojnë këtu.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Jashari. Është koha ta jap atë informatë, unë nuk e dhashë në fillim për shkak se desha t'ju jepja përparësi juve. Me kërkesën me shkrim të presidentit të Kosovës z. Fatmir Sejdiut sot në orën 12, që njëherësh është kryetar i Grupit për Statusin, do t'i drejtohet Kuvendit të Kosovës lidhur me bisedimet në Vjenë. Unë mendoj se nëse ka edhe të tjerë që e shtrojnë këtë problem, do ta kenë këtë përgjigje, d.m.th sot në orën 12 ne do ta dëgjojmë raportin e presidentit të Kosovës dhe të prijësit të grupit për statusin e Kosovës. Ju po e shihni që unë jam duke e drejtuar seancën, sepse momentalisht i gjithë ai grup është në bisedë me ambasadorin Vizner, përfaqësues i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për bisedimet, kështu që kjo do të jetë në rend dite bile në orën 12.
Emrush Xhemajli e ka kërkuar fjalën.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Ju përhëndes të gjithëve, i nderuari kryesues, unë propozoj që pika 14 e disa u hoqën po të jetë pika e fundit, caktimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme si është bërë praktikë të vazhdoj sikur më parë, ndërkaq e

mbështes atë që u tha këtu se të gjithëve na ra në sy që në fakt elefantët asnjë nuk ishin këtu. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Atë që e kërkon deputeti Xhemajli ajo është në rregulloren e punës së Kuvendit që në seancën paraprake propozohet një rend dite për seancën e ardhshme dhe kjo që propozoni ju është në rregull, ju e dini që ky tip i propozimeve është bërë në dy tri mbledhjet e fundit thjesht për shkak se ka qenë gati e pamundur që të saktësohet rendi i ditës për seancën tjetër, si do që të jetë kërkesa juaj është në rregull dhe mund të bisedohet për këtë.

Fjalën e ka Xhevat Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Faleminderit z. kryesues. Unë meqë vij nga komuna e Vitisë jam i detyruar t'ju informoj se Kuvendi komunal i Vitisë ka mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme pas propozimit të Grupit për bisedime që në territorin e komunës së Vitisë të krijohet edhe një komunë e re etnikisht serbe. Ky kuvend komunal dhe të gjitha forcat politike të Vitisë janë pjesëmarrëse në këtë Kuvend ishin unike kundër propozimit të Grupit dhe kundër krijimit të një komune tjetër në territorin e komunës së Vitisë. I vetmi që ka përkrahur Grupin Negociator dhe propozimin e tij ka qenë një këshilltar komunal i pakicës serbe, të gjithë të tjerët kanë qenë kundër, prandaj unë kërkoj nga Kuvendi që urgjentisht ta rishqyrtojë pozicionin e këtij grupi, propozimet që i bën ai dhe në një pikë të veçantë të hapet një debat për një referendum për mundësinë që populli i Kosovës ta thotë fjalën e vet vetë dhe të mos ua lenë as elefantëve, as arushave, as luanëve. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit, ky është sugjerim për punën e Kuvendit, natyrisht kurrfarë procedure nuk jep mundësinë që kjo pikë të hyjë në rend dite sot, por le ta marrin Kryesia dhe Kuvendi në Konsideratë që problemi të shqyrtohet. Fjalën e ka kërkuar Xhezair Murati.

POSLANIK DŽEZAIR MURATI - Hvla g. predsedavajući, ja vas pozdravljam. G-dine ministre i kolege. Vi ste upravo nas obavestili da će predsednik Kosova g. Sejdiu da nam se obrati danas u 12,00 sati. To se nekako opodudara upravo sa razgovorom sa specijalnim predstavnikom Sjedinjenih Američkih Država, ambasadorom Viznerom koji će u isto vreme razgovarati sa predsednicima manjinskih partija, dakle to se poklapa sa terminom da li je moguće s obzirom da je i ranije utvrđen termin razgovora sa g. Viznerom, da nam se predsednik obrati malo kasnije da bismo i mi mogli prisustvovati njegovom obraćanju, samo to je jedan naš zahtev. Hvala.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Nuk varet kjo prej nesh dhe ju i keni obligimet , unë mendoj që vetë deputetët i zgjedhin prioritetet e veprimeve të veta. Fjalën e ka kërkuar Gjergj Dedaj.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Faleminderit z. kryesues. Të nderuar ministra, kolegë deputetë. Pa dyshim se do të kishte qenë mirë si në të gjitha vendet demokratike që grupi i cili ka qenë në Vjen edhe para shkuarjes ta njoftoj Kuvendin e Kosovës që të mos shkelej sovraniteti i Kuvendit të Kosovës që reflekton vullnetin e popullit të Kosovës. Edhe pas ardhjes është mirë dhe e përshëndesim gatishmërinë e presidentit Sejdiu që të raportoj dhe mund të them se edhe në emër të Grupit për Integrim kërkojmë që e gjithë

puna e këtij grupi të jetë transparente dhe qytetarët e Kosovës rregullisht të njoftohen për të gjitha zhvillimet sepse çështja e statusit të Kosovës nuk është çështje vetëm e grupit apo e disa subjekteve politike, por e gjithë spektrit politik dhe e gjithë popullit të Kosovës. Njëkohësisht në emër të Grupit për Integrim kërkojmë nga organet e sigurisë në Kosovë me qenë se këtu është edhe ministri, i nderuar, i Sigurisë, Rexhepi që të zhvillojë hetimet për rastin e mbrëmshëm kur në rrethana të pasqaruara, siç ka njoftuar sot edhe Radiotelevizioni i Kosovës është gjuajtur në hyrje të Prishtinës, ka pasur një tentim atentati në kryetarin, shefin e Grupit Parlamentar për Integrim deputetin Sabit Rrahmani edhe një herë kërkojmë nga organet e sigurisë që t'i marrin të gjitha masat dhe ta zbardhin këtë rast. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Dedaj, ne nuk kemi asnjë kërkesë të re rreth rendit të ditës, ju lutem a pajtoheni që rendi i ditës të aprovohet me këto ndryshime.

Për shumica. Ju faleminderit!
Kundër 1 kundër
Abstenim..... nuk ka.

Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit të seancës së 13, 14 dhe 17 korrikut 2006. Ju e keni marrë tekstin e procesverbalit, sipas zakonit tonë ju keni mundësi që gojarisht ose me shkrim t'i drejtoheni nëse keni vërejtje ose plotësime të procesverbalit të Zyrës për Parashtrime dhe Kërkesa të sekretarisë së Kuvendit.
Fjalën e kërkon Hatixhe Hoxha

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA – Z. kryesues në transkriptin që e kemi marrë në faqën 119 në fjalën time që i drejtohem raportit të Qeverisë, ministrit Ahmeti, disa fjali kanë rënë dhe ndërliken pastaj me punën e Qeverisë në AKM që nuk ka kuptim kjo. Unë do t'ia ofroj fjalën time stafit dhe le ta korrigjojë atë, por desha ta them edhe para jush. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Do të rregullohet sipas normave kjo. Fjalën e kërkon Behxhet Brajshori.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – Z. kryesues. në faqen 112 është bërë një lëshim sigurisht teknik. Unë kam thënë : “në vitin 2006 rritja reale e GDP –is do të jetë 3% e jo 8%”. Le të bëhet ky korrigjim ju lutem.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Korrigjimet, sa po i shoh unë, të gjitha janë për transkriptin.

Fjalën e ka Fetah Berisha

DEPUTETI FETAH BERISHA – Faleminderit z. kryesues. Po ashtu edhe unë e kam një vërejtje. Fjalën e kam për transkriptin e seancave të fundit, ku është bërë një gabim i madh. Në faqen 74 në diskutimin tim, është bërë një gabim sintaksor. Në qoftë se renditja e fjalëve në fjali nuk bëhet sipas sintaksës që është shumë e ndjeshme. Unë kam thënë kështu: “Në këtë kuvend disa njerëz të opozitës kanë bërë akuza të mëdha në adresë të Qeverisë etj.” ndërsa atje ka dalë: “ Në këtë Kuvend disa njerëzve të opozitës u janë bërë

akuza etj, etj” , nuk është hera e parë që bëjmë këso vërejtjesh. Atyre që merren me këtë punë ju lutem t’i sugjeroni edhe nëse nuk e njohin gjuhën mund të jetë ndonjë lëshim teknik po jo kështu, prandaj u sugjeroni atyre të mos lëshojnë gabime të tilla se nëse nuk bëhet renditja e mirë e fjalëve në fjali, ndërrohet mendimi dhe kuptimi që e ka thënë “iksi”. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – E dëgjuam vërejtjen e deputetit. Fjalën e ka Genc Gorani.

DEPUTETI GENC GORANI – Ju faleminderit z. kryesues. Po ashtu është p një korigjim në transkript. Në fjalën time, në një vend në transkript është thënë : “Aksidenti në Prizren ka ndodhur për shkak të një çështjeje të nderit, Nuk është të nderit, por të tenderit. Kishe qenë mirë të jepet një mundësi që këto gabime t’i korigjojme jashtë seancës, sepse janë evidente. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. deputet. Fjalën e ka kërkuar Jonuz Kastrati.

DEPUTETI JONUZ KASTRATI – Faleminderit kryesues. Në faqen 78 të transkriptit ,aty ku përmendet fjala: Ku kolegu Mujota përmend Gjakovën, unë kam thënë : Unë po përmend Malishevën, ndërsa këtu ka dalë : Unë nuk po përmend Malishevën. Kaq.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Fjalën e kërkon Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Në transkript nuk bëhen vërejtje. Në rend të ditës është procesverbali e jo transkripti.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Nekibe Kelmendi. E di edhe unë, por deputetët kanë të drejtë publikisht t’i shprehin mendimet e veta dhe meqë është fundi u bashkohem të gjithëve dhe po ju them se problemi me transkript është problem kulturor, sepse kemi transformimin e gjuhës së folur në gjuhën e shkruar. Vetëm specialistët e mirë dinë ta bëjnë këtë. Unë edhe diskutimet e mia që i bëj në princip të folura, atje i gjej katastrofalisht të shkruara për shkak se njerëzit janë mësuar të shkruajnë tekste të shkruara, të klishezizuara, prandaj nuk dinë t’i qesin shenjat e pikësimit, t’i qesin ku duhet. Këtu pajtohem me ju, por kjo do të përmirësohet gradualisht. Nuk besoj se do të bëhet mirë deri në mbledhjen e ardhshme. Faleminderit!

Fjalën e kërkon Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Arsyeja pse e kërkoja fjalën është jo e mënyrës si e thatë. Nëse ne jemi në rend të ditës ku flasim për procesverbal, atëherë bisedojmë për procesverbal, por nëse këtu bisedojmë edhe për transkript ,atëherë ju lutem që rendi i ditës të jetë i tillë. Transkripti dhe procesverbali nuk janë njësoj. Ne kemi procesverbal, kemi edhe transkript.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Jo nuk janë njësoj e tha edhe Nekibja, por kjo është një brengë e deputetëve dhe ata kanë të drejtë ta thonë fjalën dhe e thanë në mënyrën e vet secili, atëherë unë thërras që ta votojmë procesverbalin.

Kush është për? Ju faleminderit. Kundër, nuk po shoh. Abstenim nuk ka. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

3. Pyetjet e deputetëve për Qeverinë e Kosovës

Unë ju kujtoj që vetëm një minutë është koha e pyetjes, tre minuta është e drejta e ministrit të përgjigjet. Nëse eventualisht ka pyetje plotësuese, kjo mund të jetë një minutë dhe eventualisht përgjigja 2 minuta. Ne e kemi një rend të pyetjeve për këtë seancë për ministrat dhe për Qeverinë. Deputetja Zylfije Hundozi për ministrin Shatri. Deputeti Xhezair Murati për ministrin Sllavisha Petković, deputeti Xhevat Bislimi për ministrin Sadik Idriz, deputetja Zylfije Hundozi për ministrin e Tregtisë, Bujar Dugolli. deputeti Genc Gorani për ministrin Fatmir Rexhepi, deputetja Fatmire Mulhaxha – Kollçaku për kryeministrin Agim Çeku.

Jua sjell ndërmend se këto janë pyetje që nuk kanë marrë ende përgjigje që do të hyjnë në punë nëse ka ministra përkatës edhe sot dhe për pyetjet që janë shtruar para kësaj seance. Kemi një pyetje të deputetit Berat Luzha për kryeministrin Agim Çekun. Deputetja Sala Berisha – Shala për ministrin Gjini, deputetja Sala Berisha – Shala për ministrin Shatri, deputetja Sala Berisha Shala për deputetin Qemajl Ahmeti dhe deputeti Xhevat Bislimi për ministrin Ethem Çeku.

Nisëmi nga deputetja Zylfije Hundozi për ministrin Shatri. A e kemi ministrin këtu? Nuk është ministri Shatri. A doni ta shtroni pyetjen me gojë pa marrë parasysh që nuk është ministri apo bartet tutje.

Kalojmë në pyetjen e dytë. Deputeti Xhezair Murati ka pyetje për ministrin Sllavisha Petković.

POSLANIK DŽEZAIR MURATI- Hvala g. predsedavajući. Ja pozdravljam zamenika premijera i ministre i g. Petkovića na prisustvu. Ja sam više puta razmotrio problematiku ministarstva koje se zove Ministarstvo za povratak i zajednice. Samim tim što se zove za zajednice, ja sam im postavio pitanje „Kakav je sasatav zaposlenih u Ministarstvu za zajednice i koliko se vodi računa o zaposlenima iz drugih zajednica, iz neserpskih zajednica. **RYESUESI SBRI HAMITI** – Sipas Rregullores mund të bëhet vetëm një pyetje për ministrin, ju për pyetjen tuaj keni variante që shkojnë deri në tri pyetje. Unë po ju them z. deputet përcaktohuni për cilën pyetje jeni sot.

POSLANIK DŽEZAIR MURATI – Ja sam ga upravo postavljao g. predsedavajući.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Atëherë thërrasim ministrin Sllavisha Petković që të përgjigjet.

MINISTAR SLLAVIŠA PETKOVIĆ – Ja moram da kažem da sam dobio tri pitanja a ne jednu, ja ću da odgovorim na sva tri. U ministarstvo je sledeće, u ministarstvu imate 57 radnika srbske zajednice, 41 pripadnik albanske zajednice, 8 pripadnika bošnjačke zajednice, 4 pripadnika turske zajednice, 3 pripadnika egipčanske zajednice, 1 aškalijske, 1 goranske, što ukupno čini 115 zaposlenih, pa čak imate od toga 76 muških, 39 ženskih gde smo vodili i tih 30% računa o zapošlenosti u ministarstvo, to je prvo, drugo, kada se radi o prijem radnika ne odlučuje ministarstvo koga će primiti, tu imate i pripadnika OEBS-a i svaki radnik u ministarstvu, u administraciji prolazi kroz konkurs, što znači da namećemo u administraciji, pravo zamenika ministra je da uzima asistente iz svoje

zajednice ali u ministarstvo ni ministar ne može da odlučuje ko će biti zapošljen zato što ide redovnim konkursom.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Z. deputet ,a ke pyetje plotësuese? Urdhëro.

POSLANIK DŽEZAIR MURATI - Odgovor o kojom odgovori g. Ministar nije u formi u kojoj je sada dat, jer je verbalan, dakle samo saopšten, i drugo u odgovoru ministra danas imamo tačno procentualno ali je u pitanju da li je nekoliko puta u istom ministarstvu su primani otpušteni radnici, a istovremeno pri odgovoru meni je poslato pitanje kao poslaniku, ja smatram paradoksom da ministar pita poslanika a u stvari bude obrnuto kako je to praksa i ja ovo pitanje koje je meni dostavljeno pismeno koju imam ovde prosleđuje ministru zdravlja a ne meni, jer pitanje se odnosi na ministarstvo zdravlja skojim imam veze koliko i svi poslanici Skupštine i ja smatram da nije odgovorajući sastav zaposlenih u ministarstvu za povratak i zajednice, ne odgovora potrebama i strukturi, kako stanovništvu, tako i zaposlenih.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ministri, a ka përgjigje?

MINISTAR SLAVIŠA PETKOVIČ - G. Murati da vam kažem nešto, ni jedno ministarstvo nije stranački ministarsstvo, i vi imate pravo da budete zadovoljni ili ne, ja opet vam kažem kompletna administracija prolazi kroz konkurs, a inače ovo pitanje je pitanje za celu Vladu, Vlada treba ta odgovori komplet koliko je struktura manjinskih zajednica u kompletnoj vladi a ne posebno u jedno ministarstvo zato što ona nosi naziv za povratak ili za zajednice, to nema nikakve veze, ministarstvo je ministarstvo i ministarsstvo koja vodi nikada neće biti stranačko i ja nisam tu da bih zadovaljavao stranačke interese bilo koje zajednice, većinske ili manjinske jer sada vam kažem i možete da proverite sa zapisnicima u ESE-u, svaki radnik administracije je prošou konkurs za koji se dao ili nije dao saglasnost, i druga stvar što se tiče otpuštanje radnika znači to je politika Vlade posle ugovora sa MME-fom i još jedna stvar da vam kažem to je unutrašnja stvar ministarstva u kojoj komisija i u kojoj vi pripadate nema zakonsko opravo da se meša. Vi ste tu da predete zakone koji se tiču manjina i ostalih zajednica koje se usvajaju u Parlamentu, a niste tu da vodite računa da li se struktura ovakve ili onakve ministarstvo, to ipak radi u ES-e verujte mi i kada je konkurs u pitanju radi se i posmatraju se. Hvala.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Xhevat Bislimi ka pyetje për ministrin Sadik Idriz.

DEPUTETI XHEVAT BISLMI – Faleminderit. Unë e kam bërë një pyetje për Ministrinë përkatëse dhe për Qeverinë, pikërisht për banjën e Kllokotit. Drejtuesit e kësaj organizate dhe kolektivi i saj kanë bërë një kërkesë në Qeveri që kjo banjë, kjo organizatë, kjo qendër rehabilituese -shëruese të mos privatizohet, por të mbetet qendër për shërim – rehabilitim, qendër publike me interes publik. Unë e kam bërë një pyetje - A është shqyrtuar deri më sot kjo kërkesë apo nuk është shqyrtuar nga Qeveria.?

KRYESUESI SABRI HAMITI – E ka fjalën ministri Sadik Idriz.

MINISTAR SADIK IDRIZ - Hvala predsedavajući. Poštovane poslaniče Bislimi, odgovarajući na vaše pitanje ja želim da vam informišem da Ministarstvo zdravlja imala

više sastanaka sa predstavnicima Klokot banje kot Vitine i banje Ilida kod Istoka na kojem se raspravljalo o budućem pravnom statusu ovih institucija. Tokom posetama ovim dveju institucija koji su predstavnici ministarstva su obavili ponudena je određena dokumentacija sa njihove strane i snižan zahtev da ove institucije ne uđu u spisak za privatizaciju od strane AKM već da stanu u sastavu ministarstva za zdravlje. Pravna kancelarija ministarstva za zdravlje je razmatralo zakonsku regulativu na snazi i određene uredbe koju razmatraju ovu problematiku. Međutim na osnovu člana 2 i 3 UNMIK-ove uredbe o formiranju KPA upravljanjem javnom i društvenom svojinom prelazi potpunom kompetencijom KPA, tako da ona ima potpune kompetenciju u procesu transformacije javnih i društvenih preduzeća. Tako KPA ovom uredbom obezbedila neograničeno ovlašćenje u procesu privatizacije i menadžiranjem ovom imovinom. Postala je potreba za jednim organom u vezi nadgledanja i kontrolisanja provođenja zakona i određenih uredbi u procesu privatizacije, identifikacije i propusta u ovom procesu kao i u brzom reagovanju u konkretnim slučajevima. Ovo odgovornu ulogu možda je trebalo da preuzima Skupština Kosova kao najviši zakonodavni organ i da ima dominantnu ulogu u nadgledavanju procesa privatizacije. Međutim mi to do sada nismo imali. Naši naponi da promenimo nešto u ovom pravcu su podržani od strane Vlade Bajrama Redžepia koja je jednom odlukom odredila kao obekte Vlade sa posebnim značajem za građane Kosova Klokot Banju, Banju Ilidža kod Istoka kao i Farmed. Ministarstvo zdravlja takođe zvaničnim dopisom upoznao kosovsku poverilačku agenciju o značaju ovih objekata i posledice njihove privatizacije humane funkcije kao i životne potrebe za građane Kosova sa lakšim pristupom, preventivi lečenjem i rehabilitaciju. Međutim već 6 meseci ministarstvo zdravlja nije dobilo zvanične odgovore od stane poverilačke agencije. Ovo pitanje ima veću težinu ako se uzme u obzir teško socijalno stanje građana, niski standard života i olakšice prilikom apliciranja za korišćenje usluga u ovim institucijama.

Ministarstvo zdravlja predlaže Skupštini Kosova da za Klokot Banju i banju Ilidža kod Istoka donese odluku i proglase za institucije od posebnog značaja za zdravlje i opšte interes građana Kosova, i da traže od specialnog predstavnika da donese odluku da pomenute banje ostanu u sastavu ministarstva zdravlja Vlade Kosova. Hvala.

KRYESUESI SABRI HAMITI - Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Faleminderit! Unë e kam bërë një pyetje për Ministrinë përkatëse dhe për Qeverinë, pikërisht për banjën e Klokotit. Drejtuesit e kësaj organizate dhe kolektivi i saj kanë bërë një kërkesë në Qeveri që kjo banjë, kjo organizatë, kjo qendër rehabilituese -shëruese të mos privatizohet, por të mbetet si qendër për shërim – rehabilitim - qendër publike me interes publik. Unë e kam bërë një pyetje . A është shqyrtuar deri më sot kjo apo jo nga Qeveria?

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. ministër. Deputeti, a ka pyetje plotësuese?

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Propozimin që e bëri ministri këtu që Kuvendi të marrë një vendim që kjo banjë dhe banjat e tjera të mbeten si qendra me interes publik, a ja ka bërë këtë propozim Ministria Kuvendit zyrtarisht? A i ka bërë kërkesë Kuvendit që këto qendra të mbeten me interes publik?

MINISTAR SADIK IDRIZ – Nije zvanično, ali rekao sam da prethodna vlada, Vlada Redžepia, znači prva vlada zvaničnom odlukom je donela doluku Vlade i zatražila da to ostane. Ovoga puta dodatno se obraćam i ako treba prosledćemo zato što već Vlada donela doluku i Vlada je tražila da to ostane u sastavu Vlade, odnosno Ministarstvo zdravlja. Mi imamo probleme i sa penzionerima koji su više puta dolazili kod nas i zahtevaju da te institucije ostanu, međutim znajte da to ne zavisi od nas, mi možemo i Vlada da donesemo odluku, ali sve leži kod specijalnog predstavnika. Hvala.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit! Kemi pyetjen e deputetes Hundozi për ministrin Dugolli që nuk është këtu. Kjo shtyhet.
Deputeti Genc Gorani ka pyetje për ministrin e Rendit z. Fatmir Rexhepin.

DEPUTETI GENC GORANI – Z. ministër. Autoriteti Rregullator për Telekomunikacionin dhe inspektoratet përkatëse në bashkëpunim me autoritetet e pushtetit lokal në Pejë kanë tentuar ta ndalin veprimtarinë ilegale të disa operatorëve të telefonisë mobile në këtë qytet. Kjo përpjekje e institucioneve të Kosovës ka dështuar për shkak të mospërkrahjes së Shërbimit Policor të Kosovës. Këtë e them duke u bazuar në raportet e ART-së dhe të pushtetit lokal në Pejë. Pejën e kemi vizituar si Komision disa ditë më parë.

Pyetja për ju z. ministër është: Nëse Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit dhe inspektoratet gjegjëse do të ndërmirreshin sërish këtë veprim ligjor, a e garantoni ju z. ministër përkrahjen e SHPK-së këtë herë? Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI - Fjalën e ka ministri.

MINISTRI FATMIR REXHEPI – I nderuari kryesues, të nderuar kolegë të kabinetit qeveritar. Deputeti Genc Gorani e ka parashtruar pyetjen lidhur me çështjen që e tha, por e ka parashtruar besoj me vonesë, më 25, dje ishte 26, kështu që unë nuk e kam marrë atë pyetje, pos asaj që e dëgjova këtu drejtpërdrejt. Sa i përket konstatimit se a do të garantojë Ministria që Shërbimi Policor i Kosovës do t'i respektojë vendimet ligjore aty nuk ka asnjë dilemë, por është çështje tjetër se ART-ja, harmonizimi dhe komunikimi i institucioneve lokale i ART-së me procedurat ligjore, që duhet të respektohen deri në marrjen e një vendimi, implementimin e tij përkatësisht përkrahjen nga Shërbimi Policor i Kosovës. Pra, kjo as nuk ka munguar dhe as nuk do të mungojë. Për seancën tjetër unë do të marrë me shkrim nga SHPK –ja lidhur me rastin krejt kronologjinë çka ka ndodhur dhe si kanë ecur punët. Pra, në seancën tjetër do ta merrni përgjigjen. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Z. Gorani pas kësaj a keni të shtoni diçka?

DEPUTETI GENC GORANI – Nuk është nënpyetje, por e shfrytëzoj rastin ta cek se pyetja i është përcjell administratës me kohë, 48 orë para seancës. Mu për këtë arsye ka hyrë si pyetje këtu në seancë. Është çështje e administratës se është dashur t'ia përcjellë Ministrisë.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Administrata thotë se është përpjekur që në afatin më të shkurtër të mundshëm, por keni kujdes se për një 48- orësh nuk është lehtë të bëhet komunikimi me shkrim dhe me pyetje, ndoshta është afat tepër i shkurtër. Ta shohim se

çka do të bëjë Kuvendi .Pastaj sido që të jetë, ministri do ta ofrojë përgjigjen kur të përgatitet.

Deputetja Fatmire Mulhaxha – Kollçaku si dhe deputeti Berat Luzha kanë pyetje për kryeministrin Agim Çeku. Kryeministri nuk është këtu. Unë nuk di a ka ndonjë ministër që ka marrë autorizim eventualisht, sepse ka të drejtë t'u përgjigjet pyetjeve . Nëse jo ,të vazhdojmë.

Fjalën e ka deputetja Kollçaku.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA – KOLLÇAKU – Qeveria e Kosovës, më 31 maj 2006, ka marrë vendim për fillimin e zbatimit të kontratës së përgjithshme kolektive ,nenit 23 të kësaj kontrate- pushimi i lehonave, në mënyrë retroaktive.Nga data 1 janar 2006, vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit. Pse ky dokument nuk u është shpërndarë institucioneve, pse nuk ka filluar zbatimi? A do ta ketë fatin e asaj në të cilën thirret se është kontrata kolektive e nënshkruar në janar të 2005 ende nuk është realizuar. Nuk kemi pasur nevojë për këtë vendim nëse nuk hyn në fuqi menjëherë. Unë konsideroj se mjetet paraprakisht sigurohen e pastaj lëshohet një vendim i tillë, pëndryshe është përsëritje e së njëjtës. Kërkoj një përgjigje dhe lus qeveritarët që t'ia përcjellin kryeministrin. Përgjigjen e kisha dashur sa më parë, sepse lehonat tashmë e rifillojnë punën, pas 3 muajve dhe në këtë mënyrë janë të diskriminuara. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit. Tash i kemi pyetjet që janë shtruar më herët. Unë ju thashë se do ta marrim kohën tonë që ku ka mundësi t'u përgjigjemi edhe këtyre pyetjeve.

Deputetja Sala Berisha – Shala ka pyetje për ministrin Ardian Gjini. Pyetja më duket se është shtruar edhe një herë. A doni ta përsëritni.?

Fjalën e kërkon Agim Krasniqi.

DEPUTETI AGIM KRASNIQI – Unë e pata një vërejtje. Nëse vazhdojmë kështu për çdo seancë nga 100 pyetje, do të duhej të organizoheshin seanca të veçanta për pyetje të deputetëve. Jemi 110 deputetë këtu dhe 110 pyetje mund t'i shtrojmë, plus në kuadër të pyetjeve mund të ketë edhe pyetje të tjera. Unë mendoj se kjo nuk është efektive . Unë propozoj, nëse ka pyetje të tilla të shkurtra, le të shtrohen me shkrim, le të marrin përgjigje me shkrim, por jo edhe në seancë të gjitha pyetjet të publikohen. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Z. deputet Krasniqi. Ju lutem shumë lexojeni mirë Rregulloren e Kuvendit dhe mos na merrni kohë për interpretime personale. Për këtë pikë të rendit të ditës ju keni votuar që në çdo mbledhje mund t'i marrë 50 minuta. Unë e kam stopuar kohën dhe i kemi harxhuar 20 minuta dhe është e drejtë jona dhe efekt yni që nëse kemi mundësi t'i shterrim të gjitha pyetjet. Kur të bëhen 50 minuta unë do ta ndërpres këtë pikë të rendit të ditës.

Fjalën e ka znj. Shala.

DEPUTETJA SALA BERISHA – SHALA - Çështja është se mbi pjesën e rehabilituar dhe të gjelbëruar nga Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësinor , kohë më parë, në brezin përgjatë segmentit rrugor, në vendin prej stacionit të autobusëve në Prishtinë, në drejtim të unazës së qytetit ,tani punohet në zgjerimin e atij brezi rrugor në dëm të gjelbërimit. Pyetja për ministrin: A keni ndërmarrë diçka për ndërprerjen e një aktiviteti

të tillë ,që është në kundërshtim me projektin e realizuar nga Ministria juaj që është përgjegjëse për planifikim hapësinor, apo mos është ndonjë marrëveshje e të dy ministrive?

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ministri Gjini.

MINISTRI ARDIAN GJINI - Faleminderit i nderuari z. kryesues, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës. Përgjigja është kjo: Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor nuk e ka gjelbëruar atë zonë. Në vitin 2003 është ndërmarr një aksion me komunitetin për pastrimin e njëhershëm të zonës për largimin e mbeturinave,që e kanë bërë **komuniteti dhe Ministria**, ndërsa gjelbërimin dhe rregullimin e zonës e ka bërë komuna e Prishtinës. D.m.th.pyetja i ka dy sugjestione dhe i kisha lutur deputetët që të krijojnë mundësi që gjithmonë të na pyesin paraprakisht dhe t'ua japim të gjitha informacionet e mundshme ,në mënyrë që të mos ketë elemente në pyetjet të cilat më vonë do të shihen se nuk janë të tilla. Ne për të gjitha informacionet jemi të obliguar dhe me plotë dëshirë ju ofrojmë gjatë gjithë kohës.Nuk e ka gjelbëruar Ministria,sepse ajo nuk merr pjesë në rregullimin e rrugëve nëpër komuna, janë vendime të plotfuqishme të komunave. Ato kanë të drejtë, ata njerëz zgjidhen me vota dhe marrin vendime ku duhet të ndërtohen rrugët ose ku nuk duhet të ndërtohen ato. Ministria e Mjedisit intervenon vetëm atëherë nëse rrugët ose objektet e mëdha infrastrukturore i cenojnë rrugët ose objektet e mëdha infrastrukturore nacionale në relacion me komunën. Kjo është përgjigja. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Zonja deputete, a keni pyetje plotësuese?

DEPUTETJA SALA BEERISHA – SHALA – Unë e di se i kam parë edhe njerëzit e Ministrisë aty, pra ky qenka një bashkëpunim me komunën, por një pjesë ka qenë e gjelbëruar kur nuk ka qenë ministër z. Gjini dhe është një pyetje shtesë se a është ndërtim apo shkelje ligjore në fushën e planifikimit dhe të urbanizmit? I di edhe rregullat sa metra është prej distancës së rrugës ajo pjesë e komunikacionit dhe e rrugëve.

MINISTRI ARDIAN GJINI – Rregullat që janë të vendosura me ligj nganjëherë në Kosovë kanë dallim në krahasim me atë që mendojmë ne si duhet të jenë ato rregulla. Komuna e Prishtinës ka të drejtë të marrë vendim për ndërtimin e rrugës,nëse nuk i cenon zhvillimet e mëdha infrastrukturore nacionale ajo rrugë. A na pëlqen ne rruga apo nuk na pëlqen është çështje tjetër. Por a mendojmë ne se rregullat ekzistuese duhet të jenë ashtu apo jo, është diçka tjetër, mirëpo vendimi për ndërtimin e asaj rruge është plotësisht kompetencë e kuvendit komunal të Prishtinës dhe nuk ekzistojnë rregulla që përcaktojnë sa duhet të jetë shiriti i gjelbërimit ose sa duhet të jetë e gjerë rruga në relacion me shiritin e gjelbërimit. Tani për tani në Kosovë nuk ka këso rregullash. Nëse ky kuvend në të ardhmen do ta nxjerrë një ligj të tillë, atëherë ato me siguri do të respektohen. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. ministër. Tani pyetjet e deputetes Shala për ministrat Shatri dhe Ahmeti, nuk mund të marrin përgjigje ,sepse ministrat nuk janë këtu, por marin përgjigje herën tjetër.

Deputeti Xhevat Bislimi ka pyetje për ministrin e Energjisë dhe të Minierave Ethem Çeku.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Faleminderit z. kryesues. Z. ministër, gjendja energjetike në Kosovë vazhdon të jetë tepër e rëndë, mashtrimi, fjalë të mëdha, premtimi se do të rregullohet gjendja, janë të përditshme, nuk mbarojnë asnjëherë. Më duket që edhe sot Kosova është në terr. Blloqet bien herë njëri- herë tjetri. Unë e kam bërë një pyetje. Të gjithë jemi me siguri të informuar, të ndërgjegjshëm për pasojat që kjo gjendje energjetike që KEK-u i shkakton qytetarit , ekonomisë sonë, ekonomisë familjare, nxënësit, studentit që i kushton me mijëra orë mësim,të mos futen aty ndotja e ambientit nga agregatët, dëmet e shëndetit publik etj, etj. Unë kam kërkuar dhe kërkoj nga ju si Qeveri, si Ministri a keni bërë ndonjë vlerësim, a ju ka shkuar mendja ndonjëherë ta bëni ndonjë.....*ndërpritet incizimi.*

KRYESUESI SABRI HAMITI – Fjalën e ka ministri Çeku.

MINISTRI ETHEM ÇEKU – Faleminderit z. kryesues. Unë dua ta falënderoj edhe deputetin në fjalë që e ka shtruar një pyetje. Nuk pajtohem me ato mashtrime që i përdor , është kjo çështje juaja Në kohën e fundit ka pasur zhvillime pozitive në fushën e furnizimit me energji elektrike, mirëpo ato zhvillime nuk janë të kënaqshme as për ne as për Qeverinë dhe as për qytetarët e Kosovës. Pajtohem plotësisht që këto zhvillime nuk janë aq të kënaqshme. A kemi bërë studime? Kemi bërë studime. Banka Botërore ka bërë një varg studimesh që nga viti 1999 e këndeje për të gjitha implikimet edhe financiare edhe në zhvillimin ekonomik dhe në shumë sfera të ndikimit të saj, prandaj janë një sërë studimesh që u bënë nga Banka Botërore, nga Agjencia Evropiane,por edhe prej nesh .Por,më së 75% e investitorëve ngurrojnë të investojnë në Kosovë. në mungesë të furnizimit të rregullt me energji elektrike. Sipas vlerësimeve për 12 ditë të mungesës së energjisë elektrike në furnizim, humbjet e zvogëlojnë prodhimin e përgjithshëm 1% në vit, d.m.th. janë humbje tepër të mëdha. Vetëm rastet e fundit të biznesit e posaçërisht të agrobizneseve janë tepër të mëdha. Ta marrim një shembull Llamkosin që për 3 muaj ka pasur rënie të furnizimit kualitativ me energji ka humbur 1.5 milion euro. Këto janë disa nga vlerësimet që janë bërë, në mungesë të saj. Problemi i dytë i madh është edhe mungesa e inkasimit. Ju e dini, Xhevat . se 27 për qind nuk e paguajnë energjinë elektrike, 5% i kemi vetëm minoritetet, që fare nga 99-ta e këndeje nuk e kanë paguar energjinë elektrike, 5% të humbjeve të përgjithshme. Pra, energjia e faturuar 30% fare nuk paguhet, prandaj kjo është gjendja kur flasim për inkasimin dhe për refleksionet e inkasimit në zhvillimin e KEK-ut dhe në situatën energjetike në Kosovë. Çka kemi bërë ne që nga dhjetori kur jemi themeluar si Ministri deri në qershor të vitit 2006:kemi hartuar strategjinë, kemi hartuar planin për implementimin e strategjisë, kemi mbështetur ristrukturimin e korporatës, janë hartuar politikat për tërheqjen e investitorëve në termocentralin e ri, në rehabilitimin e plotë të blloqeve të Kosovës “A” dhe në hapjen e minierave. Kemi arritur një marrëveshje me Bankën Botërore për sponsorim ose për dhënien e një granti 10 milion eurosh, kemi shtyrë KEK-un të bëjë kontrata afatgjata për furnizim ,posaçërisht në dimrin 2006 – 2007.E kemi përkrahur edhe rehabilitimin e disa blloqeve që për momentin, posaçërisht blloqet “A3” dhe “A4” të cilët janë në funksion dhe prodhojnë 160 megavatë edhe pse qëndrueshmëria e bllokut është diku 60%. Këto

janë disa nga përgjigjet se çka kemi bërë si Ministri, si Qeveri për të pasur një furnizim më të qëndrueshëm me energji elektrike. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit ministër Çeku. Deputeti do pyetje plotësuese.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. ministër. Unë po e konkretizoj pyetjen. Ju si Qeveri, nuk pyeta për Bankën Botërore, a keni bërë dhe ju rekomandoj të bëni një komision qeveritar dhe nënkomisone në çdo komunë që të vlerësohet dëmi që i bëhet çdo familjeje në Kosovë nga KEK-u dhe tërthorazi nga Qeveria që e ka Ministrinë për të menaxhuar KEK-un dhe energjinë elektrike. A mund të paguhet një mall që nuk e ke? Unë nuk di si mund të shkosh t' i kërkosh dikujt ta paguajërrymën kur nuk ka rrymë. Ju faleminderit!.

Seancën e kryeson kryetari i Kuvendit Kolë Berisha

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Urdhëroni ministër përgjigjen.

MINISTRI ETHEM ÇEKU – Xhevat, dua të them edhe një herë që prej vitit 1999 e këndej janë kryer të gjitha studimet dhe analizat, madje kemi kryer aq shumë analiza dhe studime sa që e kemi problem si t' i implementojmë. Edhe unë i mora disa shembuj. Për të mos ju ngarkuar të gjithëve, janë bërë të gjitha analizat në sektorin e biznesit, sa ka humbur sektori i biznesit në Kosovë brenda vetëm 12 ditëve të mungesës së energjisë elektrike? Edhe pse nuk është kjo një përgjegjësi e drejtpërdrejtë jona, apo është një përgjegjësi e KEK-ut, mirëpo si Ministri them i kemi bërë të gjitha ato që jemi të gatshëm t'jua ofrojmë për t' i parë të gjitha analizat dhe studimet që janë refleksione në fushën ekonomike dhe në fushat e tjera. Unë vetëm edhe një shembull t'jua përmend. Dëmet për shkak të mosfurnizimit me energji elektrike sillen prej 0.25 dollarë për kilovat orë, d.m.th. humbjet janë diku 5 herë më të mëdha se çmimi i furnizimit, prandaj këto janë disa nga studimet që ne me kënaqësi mund t'jua ofrojmë. Mirëpo kërkesa jonë është të na mbështetni në projektin që ka të bëjë me inkasimin dhe ndoshta do të jem i gatshëm të sjell edhe një informacion lidhur me këtë, pra me çështjen e pagimit në këtë drejtim. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Me kaq përfundon faza e pyetjeve dhe e përgjigjeve. Nëse pyetjet nuk kanë marrë përgjigje deri më tash, ato publikohen në Buletinin e Kuvendit.
Fjalën e ka z. Hydajet Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Faleminderit z. kryetar. Unë e kam kërkuar fjalën që në fillim të kësaj pike, kur po i evidenconim pyetjet, me siguri se nuk më kanë vërejtur, e kam shtypur edhe sustën dhe kam kërkuar me dorë.

Unë dua ta riaktualizoj edhe një herë një pyetje pa fat. Fjala është për pyetjen që e kam lexuar këtu për milionat e tërmetit, nuk kam marrë përgjigje, siç kam kërkuar gojarisht. Përgjigja nuk duhet për mua, por për qytetarët e pakënaqur, për ata e kanë shtruar këtë pyetje. Unë insistoj të përgatitet përgjigja dhe të na jepet me kohë, besoj para një tërmeti të ri. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Thashë se pyetjet që nuk kanë marr përgjigje deri më tash ndërmjet dy seancave do të botohen në Buletinin e Kuvendit.

Vazhdojmë më tutje që në radhë është pika e 4 –të e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trashëgiminë kulturore

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 6 korrik të vitit 2006 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe për miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore do t'u adresohen për shqyrtim Komisionit Funkcional Përgjegjës për raportin dhe komisioneve kryesore. Ftoj zëvendësministrin e Kulturës ta marrë fjalën dhe ta prezantojë Projektligjin.

ZËVENDËSMINISTRJA, ANGJELINA KRASNIQI – I nderuari kryetar, kryeministër, të nderuar deputetë. Është hera e dytë që para jush e sjell Projektligjin për trashëgiminë kulturore, pas miratimit në seancën e 21 korrikut të vitit 2005. Më lejoni ta paraqes një arsyetim të shkurtër për rrjedhat e procesit ...të këtij projektligji. Pas miratimit të tij në seancën e 21 korrikut, Komisioni Funkcional Parlamentar e ka kryer gjithë punën e vet dhe i ka bërë të gjitha përgatitjet që ligji të paraqitet para Kuvendit për dëgjimin e dytë. Mirëpo Ministria, duke e analizuar rëndësinë e këtij projektligji në proceset politike, sidomos në proceset e bisedimeve që pritej të zhvilloheshin në Vjenë, kryesisht në sektorin e trashëgimisë kulturore, vendosi që edhe një herë ta shqyrtojë këtë projektligj, kësaj radhe duke u bërë kërkesë instancave më të larta ndërkombëtare që të na ndihmojnë. Kështu ministri i Kulturës, Astrit Haraqija, iu drejtua Këshillit të Evropës dhe të gjitha instancave të tjera, duke parashikuar këtu edhe UNESK-on që të përgjigjeshin pozitivisht për këtë projektligj. Kërkesë pozitive morëm nga Këshilli i Evropës, që na u përgjigj me kërkesë pozitive dhe na ofroi ekspertë të lartë të fushës së legjislacionit të trashëgimisë kulturore. Së shpejti u formua edhe grupi i punës në përbërje të Komisionit Funkcional të Parlamentit. Në të kishte: përfaqësues nga Ministria, përfaqësues nga Këshilli i Evropës dhe përfaqësues të minoriteteve të ndryshme e të UNMIK-ut. Më 9 dhe më 10 prill filloi hartimi i Projektligjit në Prishtinë në përbërje të këtij grupi dhe përfundoi më 24 dhe 25 në Strasburg.

Të nderuar deputetë, ajo që vlen të theksohet është që ky projektligj, që e keni para vetes, është i harmonizuar plotësisht me dokumentet ndërkombëtare relevante dhe me konventat ndërkombëtare të fushës së legjislacionit të trashëgimisë kulturore. Ky projektligj paraqet mbrojtjen, ruajtjen, promovimin, konservimin, restaurimin, administrimin e 4 fushave të trashëgimisë kulturore, siç janë: trashëgimia arkitektonike, arkeologjike, trashëgimia e luajtshme dhe shpirtërore. Po ashtu është e definuar qartë mënyra e saktë e perimetrit të monumentit që është një kufi i fushës mbrojtëse të objektit, zona mbrojtëse që nënkupton një fushë të vendit siç është definuar në nenin 2 të Ligjit për planifikimin hapësinor, fusha speciale është e definuar qartë e që është një fushë që **paraqetnga planet hapësinore** dhe që kërkon organizim të veçantë në zhvillimin dhe në planifikimin e mbrojtjes së fushës speciale, ku është caktuar qartë edhe perimetri rreth objektit të trashëgimisë.

Në nenin 4 të këtij ligji janë të definuara qartë masat mbrojtëse dhe masat legale. relacionet ndërmjet poseduesve juridikë, fizikë, shfrytëzuesit të objektit të trashëgimisë kulturore.

Në nenin 5 të këtij ligji paraqiten financimi dhe masat fiskale të trashëgimisë kulturore që në alinenë 5.4 të këtij projektligji çdo investim i bërë për punët konservuese dhe restauruese nga personat juridikë dhe fizikë, do të lirohen nga tatimi në të ardhura në shumën e investuar.

Neni 9. alineja 9.29 është definuar qartë e drejta e importit dhe e eksportit të eksponateve të trashëgimisë kulturore, ku parashihen qartë se eksporti dhe importi duhet të bëhen vetëm në pajtim me nenin 9 të këtij ligji dhe me marrëveshjet bilaterale që i parasheh ky ligj. Alineja 9.30 e këtij ligji obligon Qeverinë e Kosovës të kërkojë kthimin e eksponateve të trashëgimisë kulturore që gjenden jashtë Kosovës.

Të nderuar deputetë. Gjatë hartimit të këtij projektligji në Stasburg kishte kërkesa nga më të ndryshmet nga faktori ndërkombëtar, por ajo që ishte më e zëshmjja dhe që vlen të theksohet për të cilën njëzëri edhe Ministria, por sidomos edhe Komisioni Funkcional ,nuk u pajtuam, por me gjithë atë mbetet që t'ia paraqesim këtij Kuvendi, ku bëhet fjalë për nenin 12.4 , do të citoj propozimin e ndërkombëtarëve ,po ashtu edhe të përfaqësuesve të Zyrës së Ahtisarit.

Neni 12.4 i Projektligjit, mbi të cilin ky ligj do të jetë i aplikueshëm për trashëgiminë kulturore e fetare, do të jetë subjekt i marrëveshjeve të sanksionuara ndërkombëtarisht ose i legjislacionit pasues. Në këtë aline 12.4 Komisioni Funkcional dhe ne ,si Ministri ,kemi kundërshtuar, po e përsëris, mirëpo me qenë se ishin prezent edhe përfaqësues të Zyrës së Ahtisarit rëndësia e këtij neni është e veçantë për mirëvajtjen e bisedimeve që po zhvillohen, mendojmë se në këtë kuvend të autorizohet me një kompetencë të plotë Komisioni Funkcional në koordinim me Grupin Negociator për bisedime dhe t'u parqitet deputetëve për miratim gjatë amendamentimit të këtij ligji.

Të nderuar deputetë. dua edhe një herë për përgatitjen e këtij projektligji me theks të veçantë të falënderoj për kontribut përfaqësuesit e Komisionit Parlamentar Funkcional të Arsimit,të Shkencës e të Teknologji, po ashtu edhe përfaqësuesit e Këshillit të Evropës. Ju falemnderitt!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju falemnderit! Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të LDK-së që ta marrë fjalën.

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ - I nderuari z. kryetar i Kuvendit, i nderuari z. kryeministër, ministra dhe koleg deputetë.

Hartimi i Ligjit për trashëgiminë kulturore nga Ministria përkatëse dhe miratimi i tij në Parlamentin e Kosovës tashmë e ka bërë një histori, në dy mandatet e këtij Kuvendi ai na erdhi për të tretën herë në lexim të parë dhe na erdhi në tri versione, u mbajtën disa dëgjime publike dhe për të morën pjesë ekspertë të brendshëm dhe të jashtëm. Thënë shkurt sponsoruesi dhe Kuvendi po merren tash e 3-4 vjet më parë, kjo tregon rëndësinë e këtij ligji, se ka për objekt një sferë tejet të gjërë dhe të rëndësishme jo vetëm kulturore, qoftë si nevojë për të rregulluar një nevojë të rëndësishme, çoftë edhe për faktin se ky ligj së bashku me dy ligje të tjera lidhen me njërin nga standardet. Në tërë këtë histori të këtij projektligji Grupi Parlamentar i LDK-së ka dhënë kontributin e vet, ishte grupi ynë parlamentar që versionin e parë e kundërshtoi në lexim të parë dhe kërkoi t'i kthehej sponsoruesi. Ashtu ndodhi. Krejt kjo u bë me qëllim që ligji të dilte sa më i përkryer.

Versioni i dytë i erdhi në lexim të parë këtij kuvendi shumë më i përkryer dhe ky kuvend atij i pat dhënë përkrahje në parim, por sponsori e tërhoqi nga leximi i dytë sigurisht me kërkesën e faktorit ndërkombëtar, me qëllim që të jetë më në përputhje me legjislacionin evropian.

Tash e kemi përpara një version të tretë që në krahasim me të dytin nuk ka pësuar ndryshime aq të mëdha, por ne si grup parlamentar konsiderojmë se ato ndryshime sado të vogla të jenë kanë ndikuar për të mirë në cilësinë e këtij ligji. Ne si grup parlamentar konsiderojmë se i takon një meritë e madhe edhe Këshillit të Evropës që me ekspertët e vet, qoftë në Prishtinë, qoftë në Strasburg, ku morën pjesë edhe anëtarë përkatës të Parlamentit dhe të Ministrisë, ka ndikuar që ky projektligj të marrë formë edhe më të përkryer. Ne konsiderojmë se sponsori ka bërë mirë që në këtë version ka përfillur vërejtjet dhe sugjerimet e Këshillit të Evropës. Në formën që e kemi sot përpara ky projektligj i ka të gjitha ato vlera që e bëjnë projektligj me cilësi më të mirat.

Ky projektligj tashmë është harmonizuar me të gjitha dokumentat dhe me konventat ndërkombëtare, me të vihen në mbrojtje të gjitha monumentet e trashëgimisë kulturore, të të gjithëve pa dallim, d.m.th. merret në mbrojtje trashëgimia kulturore e popullit të Kosovës ,pa bërë shkelje apo ndarje etnike, religjioze ose racore. Ligji i plotëson të gjitha normat e politikës legjislative, është i harmonizuar në të tri gjuhët që nuk ndodh shpesh në ligjet që na vijnë në lexim të parë. Ky projektligj është konciz dhe praktik për implementim dhe i harmonizuar me Ligjin për planifikimin hapësinor që është një çështje tejet e rëndësishme. Ky projektligj jep trajtim të veçantë relacionit ndërmjet pronarit dhe të drejtave të tij ,si dhe mënyrës së menaxhimit dhe të ruajtjes së objekteve kulturore. Restaurimi dhe konservimi janë saktësuar mirë në këtë projektligj. Element që e meriton të veçohet është se ky projektligj parasheh kthimin e eksponateve që ndodhen jashtë Kosovës, qoftë në Beograd ,qoftë në vende të tjera. Nuk ka dyshim se ky ligj do të ketë implikime të larta buxhetore, por meriton të nënvizohet se është shumë i qëlluar harmonizimi i tij me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, të paraqitur në nenin 5.1, në bazë të të cilit identifikohen fondet e financimit që duhet të sigurohen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës ,përfshirë nivelin qëndror dhe lokal. Të gjitha këto janë elemente që grupi ynë parlamentar t'i japë përkrahje në parim këtij projektligji. Përveç kësaj ne si grup parlamentar kërkojmë që të shpejtohen procedurat ,në mënyrë që ky ligj të kalojë sa më shpejt në leximin e dytë dhe të miratohet sa më parë për të vënë në mbrojtje një sferë tejet të rëndësishme . Së dyti edhe për ta plotësuar kushtëzimin në sferën e standardeve. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ftoj deputetin Enver Hoxhaj që në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së të marrë fjalën.

DEPUTETI ENVER HOXHAI - I nderuari z. kryetar, i nderuari z. kryeministër, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë.

Mendoj se kolegët i shtruan problemet kyçe, përparësitë që i ka ky ligj,por më lejoni që t'i jap vetëm dy- tri arsye themelore pse Grupi Parlamentar i PDK-së është në favor të miratimit sa më parë të këtij ligji.

Arsyeja e parë është që ruajtja, mbrojtja, konservimi, restaurimi dhe prezantimi i trashëgimisë kulturore edhe në Kosovën e pasluftës edhe në Kosovën e pas qershorit të vitit 1999 nuk ka qenë prioritet yni dhe Ligji për mendimin tonë paraqet një kornizë të mirëfillt që ruajtja, mbrojtja, konservimi dhe restaurimi dhe në të njëjtën kohë propagimi ose kultivimi i trashëgimisë kulturore të bëhet për Kosovën prioritet. Jemi të sigurtë që një ligj i tillë, në formën si është ofruar nga Qeveria e Kosovës. do të jetë bazë e shëndoshë që politika të tilla të jetësohen.

Arsyeja e dytë është që politikat kulturore , sidomos politikat që merren me trashëgiminë këto vitet e fundit edhe në vendet tjera në transicion dhe në Kosovë janë ballafaquar me

probleme jashtëzakonisht të mëdha në fushën e menaxhmentit kulturor, të menaxhmentit të trashëgimisë kulturore. Ligji, përveç masave dhe mekanizmave të tjerë e ka edhe një përparësi të madhe që dua ta theksoj në këtë kuvendi . Përparësia e këtij ligji është që sugjeron, propozon të formohet këshilli i Kosovës për trashëgiminë kulturore të saj që do të duhej të kalonte në Kuvendin e Kosovës, pra do të duhej të vendoste prioritete për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë dhe mbi të gjitha do të duhej të bëhej lotimi i mirëfilltë që për trashëgiminë kulturore në Kosovë buxheti të jetë shumë më i madh ,çfarë nuk ishte në të kaluarën.

Arsyeja e tretë është që ky ligj reflekton gjendjen objektive të cilën e ka Kosova dhe në të njëjtën kohë reflekton politikën kulturore të Këshillit të Evropës, të UNESCO-s, të të gjitha kartat relevante evropiane dhe botërore që merren me trashëgiminë..

Më lejoni që edhe në emër të Grupit Parlamentar dhe mbi të gjitha edhe në emër të Komisionit për Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sporte t'i informoj të tjerët që nuk kanë mund të ftohen se nesër e kemi një dëgjim publik për ligjin në fjalë. Ne i kemi ftuar të gjitha institucionet relevante, po do të ishte mirë që ata që nuk kanë marrë ndonjë ftesë janë në favor të trashëgimisë dhe merren me trashëgiminë e Kosovës ,është shtyllë kyçe për një identitet të Kosovës moderne, do të duhej të ishin pjesë e këtij dëgjimi publik dhe me vërejtjet e sugjerimet e tyre ta pasurojmë një ligj të tillë.

E mbështes kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së që në procedura sa më të shpejta, meqë një ligj i tillë është një kërkesë e Grupit të Kontaktit dhe hyn në 13 pika të cilat i janë sugjeruar Qeverisë së Kosovës që pas dëgjimit publik që do ta kem nesër që gjatë shtatorit të vijë ligji në leximin e dytë dhe sa më shpejt të miratohet në Kuvendin e Kosovës ,sepse trashëgimia nuk ka kohë të presë, por për të njëjtën kohë edhe procesi që gjendet aktualisht Kosova nuk do të duhej ta pengnim .

Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka Genc Gorani në emër të Grupit Parlamentar Ora.

DEPUTETI GENC GORANI – Ju faleminderit z. kryetar. I nderuari z. kryetar, i nderuari z. kryeministër, ministra, zonja dhe zotërinj deputetë.

Grupi Parlamentar Ora e përkrah në parim këtë projektligj. Po ashtu kërkon të mirren të gjitha masat në kuadër të mundësive administrative që miratimi i plotë i këtij ligji të bëhet sa më shpejt. Megjithatë kisha dashur t'i përmend dy çështje esenciale, se në këtë projektligj është bërë punë madhe, për një kohë jashtëzakonisht të gjatë. Seancat e punëve që i kemi zhvilluar këtu dhe në Strasburg ,në kuadër të Komisionit, por edhe me përkrahje të ekspertëve të ndryshëm, kemi ardhur deri në një instancë ku Këshilli i Evropës praktikisht e mbështet dhe e miraton këtë version, kështu që kemi ardhur në atë stad ku ne e kemi një përkrahje të nivelit të Këshillit Evropian për këtë projektligj. Në esencë jemi në përmbushje të plotë të një standardi jashtëzakonisht të rëndësishëm që është mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore . Po ashtu kemi një dokument që është në një nga kushtet e rëndësishme për këtë proces të përcaktimit të pavarësisë së Kosovës dhe që është edhe më e rëndësishme që jemi në kuadër të politikave të përcaktuara nga ky kuvend dhe që po shpresoj plotësisht përmbahet nga Grupi i Unitetit.

Një vërejtje shumë e vogël është se megjithatë, nëse ka vend për amendamentim të mëtejshëm ,që mund të jetë rezultat i dëgjimit të nesërm publik ,siç e përmendën parafolësit e mi , duhet megjithëatë ta marrim parasysh një shembull shumë i thjeshtë kur flitet për

Këshillin e Kosovës, kur flitet për trashëgimi kulturore aty në përshkrimin e projektligjit do të shihet se p.sh ku flitet për një numër të anëtarëve të këtij këshilli, ndërsa brenda ligjit në këto dy nene të vogla 4.8 dhe 4.9 nuk flitet më për numrin e këtyre anëtarëve as për përbërjen e anëtarëve, flitet vetëm për një akt nënligjor. Besoj se kjo do të mund të përmirësohet dhe korrigjohet gjatë procesit të amendamentimit pa e vënë në dyshim dinamikën e duhur.

Përsëris se Grupi Parlamentar i Orës e përkrah plotësisht këtë projektligj në parim. Ju faleminderit!.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit ! Fjalën e ka Myrvete Dreshaj- Baliu në emër të AAK-së

DEPUTETJA MYRVETE DRESHAJ – BALIU – I nderuari z. kryetar, z. kryeministër, z. ministra kolegë deputetë. Projektligji i parashtruar për miratim sigurisht që është njëri prej aktiviteteve të rëndësishme që radhazi po e kryen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Mbrojtja, ruajtja, konservimi, restaurimi dhe propagandimi i trashëgimisë kulturore të Kosovës janë njëri prioritetet më të rëndësishme të shoqërisë sonë. Projektligji për trashëgiminë kulturore është një sintezë e mirë e atyre përbërësve të nevojshëm që e bëjnë ligjin të arsyeshëm për miratim, duke filluar nga dispozitat e përgjithshme deri tek objekti dhe qëllimet, për të vazhduar me nocionet që janë vënë në formë të kondensuar dhe pa ngarkesa të tepërta terminologjike ,diskriptive, ndryshe nga paraqitja e mëparshme kur ky projektligj përshkohej nga një konglomerat shprehjesh dhe konstatimesh që e bënin të vështirë përdorshëm në praktikën legjislative dhe profesionale. Po kështu mund të thuhet edhe për pjesët që kanë të bëjnë me veprimet e organizimit, inventarizimit, pronësisë, kriteret e financimit, çështjen e rregullimit të pasurisë arkeologjike, qasjen publike ndaj trashëgimisë së luajtshme në koleksionet publike, mundësinë për të komunikuar me trashëgiminë shpirtërore si forma të shprehjes së vlerave të pasura dhe unike të trashëgimisë sonë. Projektligji për trashëgiminë kulturore të Kosovës, është ripunuar edhe një herë në bazë të vërejtjeve dhe të sugjerimeve të Këshillit të Evropës, ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ne e kuptojmë dhe vlerësojmë përpjekjen e grupit të punës për t'i ikur çfarëdo identifikimi të njëjës kulturë nga tjetra apo të një epoke më të rëndësishme nga një epokë tjetër. Kujtojmë se kjo ishte mënyra më e mirë për ta bërë ligjin për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim gjuhe, kulture, religjioni etj.

Pavarisht nga kjo mendojmë,se, me qëllim të sigurimit të qëndrueshëm të trashëgimisë sonë kulturore ,duhet të fokusohemi në zhvillimin e instrumenteve të qëndrueshme në qasjet e integruara në nivelin vertikal dhe horizontal. Për këtë qëllim në nivelin ligjvënës duhet të krijohet organi rregullues nën autoritetin e Kuvendit.Kjo është paraparë në projektligj me formimin e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore, por Grupi Parlamentar i AAK-së konsideron se ky këshill duhet të jetë nën autoritetin e Kuvendit. Gjithashtu mandati i Këshillit duhet të jetë i qartë që të reflektojë zhvillimin e planeve menaxhuese dhe caktimin e mjedisit për konservim.

Për të arritur balancim ndërmjet të kërkesës bashkëkohore për zhvillimin e jetesës, në njërin anë dhe ruajtjes së ndërtimeve historike,në anën tjetër, duhet të punohen planet menaxhuese që sigurojnë zhvillimin e mjedisit me kritere të caktuara, kujdesi për këto plane duhet të bëhen nga ky këshill. Grupi Parlamentar i AAK-së e përkrah në parim dhe do të kontribuojë që Komisioni Funkcional t'i hartojë sa më parë rekomandimet për fuqizimin e këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Deputeti Husnija Beshkoviç e ka fjalën në emër të Grupit 6+. Urdhëroni.

DEPUTETI HUSNIJA BESHKOVIQ – I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuari kryeministër, ministra, kolegë deputetë.

Grupi Parlamentar 6+ shqyrtoi Projektligjin për trashëgiminë kulturore dhe paralelisht konsiderojmë se ligji i përmbush parakushtet për t'u radhitur në procedurën e mëtutjeshme parlamentare. Si një nga detyrat me prioritet të Kosovës është edhe ky ligj në rrugën për definimin e statusit. Duke përmbushur këtë detyrë ne si Kuvend duhet të miratojmë këtë ligj që të jetë i përshtatshëm për implementimin dhe mbrojtjen reale dhe trashëgiminë kulturore.

Vërejtje konkrete kemi në nenin 4- Të Komisioni për Trashëgiminë Kulturore ku nuk janë të qarta predispozitat e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit si dhe janë të paqarta dispozitat e zonave dhe hapësirave mbrojtëse, nuk është e qartë **dispozita 9.7 ku përmendet edhe viti 1453**. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore duhet të jetë më e qartë, me gjithë atë konsiderojmë se tërë kjo është një hap përpara dhe krahas korigjimit të dispozitave të Projektligjit në komisionet e Kuvendit, ky ligj do të jetë efikas dhe i përdorshëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Ju faleminderit për vëmëndje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, në emër të Grupit për Integrim fjalën e ka deputeti Gjergj Dedaj.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Ju faleminderit shumë z. kryetar, i nderuar z. kryeministër.

Edhe Grupi për Integrim., duke parë rëndësinë e miratimit të Ligjit për trashëgiminë kulturore ,në parim i jep mbështetje nga fakti se ky ligj është edhe i domosdoshëm dhe e begaton ruajtjen e trashëgimisë kulturore që për ne në Kosovë nuk duhet të jetë e tillë vetëm pse ka një origjinë ose **begrant** etnik apo historik, trashëgimia kulturore, para së gjithash është pasuri e të gjithë kosovarëve, pasuri e Kosovës dhe na gëzon fakti se ky ligj edhe gjatë hartimit është kompaktibil me sugjerimet e ligjeve të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës. Shpresojmë se edhe Qeveria edhe sponsori e kanë pasur parasysh mundësinë financiare të zbatimit së këtij ligji ,sepse nuk është e thënë që të shkruhet bukur në letër një ligj i tillë, por duhet të ketë edhe mbështetje që ai të jetë i zbatueshëm. Besoj se edhe Qeveria edhe sponsori e kanë pasur parasysh një gjë të tillë, kështu që Grupi për Integrim sikurse edhe grupet e tjera parlamentare të Kuvendit të Kosovës, i japin mbështetje në parim këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi.

DEPUTETI MARK KRASNIQI – I nderuari kryetar, kryeministër, ministra dhe deputetë. Rrallë ndonjë ligj e ka bërë një rrugë qaq të gjatë prej propozimit e deri në miratim si ligji për trashëgiminë kulturore, megjithëse ky ligj është i lidhur edhe me kushtëzimin e statusit përfundimtar politik të Kosovës . Mendoj se Parlamenti, Komisioni, Ministria kanë bërë një përpjekje shumë të madhe gjatë diskutimit për këtë ligj, kanë dhënë kontribut shumë të madh, për ta nxjerrë një ligj sa më efikas dhe sa më të mirë. Mendoj

se çdo zvarritje tjetër ,me qenë se tash e kemi të kompletuar edhe mendimin e ndërkombëtarëve, të forumeve ndërkombëtare edhe Komisionit dhe tash të Parlamentit , duhet të kërkohet rruga më e shkurtër që ky ligj përfundimisht të miratohet në Kuvend. Unë do ta bëja një vërejtje lidhur me nenin 1.3, ku përmenden arkeologjia dhe objektet e arkitekturës. Më duket se këtu është një mangësi ,duhet të futet patjetër edhe trashëgimia etnografike kulturore, kudo që përmenden këto dy fusha ,sepse pasuria e kulturës materiale dhe shpirtërore, etnografike tradicionale në Kosovë ,është shumë e madhe , prandaj ,duhet edhe në ligj ta ketë vendin e vet. Këtu disa herë përmenden vetëm këto dy fusha, por kudo që përmenden arkeologjia dhe objektet ndërtimore ,duhet të futet edhe etnografia, ndoshta edhe historia. sepse ka dokumente historike mesjetare edhe më të hershme dhe më të vona që, gjithashtu ,hyjnë në fushën e trashëgimisë dhe duhet të mbrohen me ligj.

Sa u përket ruajtjes e mbrojtjes së këtyre monumenteve kemi pasur vërejtje dhe propozime ,por edhe intenca të minoritetit serb që veçanërisht duhet të theksohen në ligj disa objekte të tilla. Është mirë që këtu nuk bëhen dallim në atë drejtim, por mbrohet trashëgimia kulturore e Kosovës ,ku nënkuptohen të gjitha ato monumente, të gjitha ato objekte dhe e gjithë ajo kulturë që është në Kosovë dhe i përket popullit të Kosovës, pa marrë parasysh përbërjen etnike ose fetare. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Kërkoj falje që do ta ndërpresim diskutimin rreth kësaj teme dhe ta vazhdojmë pas referimit që do ta ketë kryetari i shtetit lidhur me bisedimet në Vjenë.

Pauzë deri në orën 12.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - I nderuari president.Ashtu siç jemi marrë vesh në fillim, u desh ta ndërprejmë seancën plenare, përkatësisht pikën e radhës të rendit të ditës, në mënyrë që ta dëgjojmë referimin tuaj për takimin e Vjenës.

Urdhëroni z. kryetar, e keni fjalën:

PRESIDENTI FATMIR SEJDIU

Fjala e presidentit Sejdiu para deputetëve të Kuvendit të Kosovës

I nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës z. Berisha, i nderuar kryeministër Çeku dhe ministra të Qeverisë së Kosovës, të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Delegacionit të Kosovës t'ju drejtohem juve deputetë të Kuvendit të Kosovës me një fjalë lidhur me zhvillimin e procesit të bisedimeve për statutin e Kosovës të udhëhequr nga presidenti Ahtisari në bazë të vendimit të Këshillit të Sigurimit dhe të mandatit që i është dhënë atij.

Ekipi i Unitetit gjatë kësaj periudhe disamuajshe që nga fundi i shkurtit, kur kanë filluar takimet e para, nëpërmjet delegacioneve përfaqësuese ka prezantuar qëndrimet e veta për tri tema bosht që u trajtuan në takimet e Vjenës dhe rreth të cilave gjer tani janë zhvilluar gjithësej shtatë takime.

Edhe pse në këtë kuvend janë dhënë informacione dy herë nga udhëheqësit e delegacioneve, e ndiej nevojën të ritheksoj me këtë rast se Ekipi i Unitetit, me gjithë strukturën e tij të brendshme të organizimit, duke filluar nga Grupi Politik Strategjik dhe ekipet e specializuara për çështje kushtetuese juridike, ekonomike, çështjet e trashëgimisë kulturore, etj. në përbërjen e të cilave ka të angazhuar ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, ka përgatitur dhe prezantuar në mënyrën më serioze qëndrimet e Kosovës nëpërmjet dokumenteve dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në bisedimet e Vjenës.

Bisedimet më të gjata gjer tani (pesë takime) dhe takime të tjera në nivel ekspertësh, janë zhvilluar lidhur me çështjet e decentralizimit të pushtetit në Kosovë dhe për shumë aspekte të gërshetuara brenda këtij procesi. Çështje të veçanta të debatuar më së shumti kanë qenë ato që kanë të bëjnë me formimin e komunave të reja në Kosovë, me kompetencat dhe me funksionet e tyre themelore, me një fokus të veçantë në çështjen e kompetencave të deleguara që kanë të bëjnë me financat lokale, me kujdesin shëndetësor dhe me atë sekondar, me arsimimin e lartë, me policinë dhe me drejtësinë dhe me një aspekt të veçantë është çështja e bashkëpunimit ndërmjet komunave.

Delegacioni i Kosovës, pas analizave të shumta që ka bërë dhe duke respektuar kriteret e përcaktuara me dokumentin bazë 'Parimet themelore të Reformës së Pushtetit Lokal në Kosovë' për formimin e komunave të reja, pas propozimit të mëhershëm se në Kosovë mund të formohen 3 + 1 komunë, propozimin e tij të fundit e ka ofruar me mundësinë e formimit edhe të dy komunave të reja dhe që është kompromisi ynë final. Me këtë çasje kemi dëshiruar që të kontribuojmë në drejtim të integritetit sa më të madh të komunitetit pakicë serb në proceset vendimmarrëse, pra edhe në nivelin lokal të vendimmarrjes. Aspektet tjera të veçanta rreth zhvillimeve të bisedimeve në këtë temë u janë raportuar më herët në Kuvend. Këtu duhet ndarë qëndrimin e Delegacionit të Kosovës për çështjen e Mitrovicës për të cilën kemi theksuar se mund të organizohet 'Një Qytet me dy komuna' që do të udhëhiqeshin nga një bord i përbashkët në përbërje prej shtatë anëtarësh, nga tre përfaqësues nga secila komunë, pra të komuniteteve që u takojnë dhe një përfaqësues ndërkombëtar i cili edhe do të jetë udhëheqës i përkohshëm i këtij bordi. Detalet e veçanta rreth kësaj çështje ende do të përpunohen në kuadër të këtij koncepti themelor.

Delegacioni i Kosovës ka zhvilluar edhe bisedime konkrete lidhur me çështjet ekonomike që kanë të bëjnë kryesisht me çështjen e borxheve të jashtme dhe pasurive të jashtme, çështjet e pronës dhe të drejta të tjera, interesat dhe detyrimet, pensionet, depozitat bankare të ngrira në valuta të jashtme, kërkesat e tjera të individëve për kompensim dhe humbjet kolektive. Delegacioni i Kosovës është shprehur se propozimet e tij nisen nga konteksti

i zgjidhjes së statusit i cili e njeh Kosovën si shtet të pavarur, se Kosova pranon zbatimin e parimeve kyçe të akorduara në Marrëveshjen e entiteteve tjera të ish Federatës Jugosllave lidhur me suksesionin të arritur në 2001, derisa disa çështje që kanë të bëjnë me Kosovën, të cilat nuk kanë qenë karakteristike për entitetet tjera, kërkojnë zgjidhje specifike brenda parimeve kryesore.

Të gjitha çështjet e tjera të trajtuara në kuadër të kësaj teme Delegacioni i Kosovës iu ka qasur në kuadër të parimeve themelore që kanë të bëjnë me të drejtën e suksesionit mes shteteve.

Tema që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore dhe religjioze pokështu është trajtuar në dy takime të gjertanishme dhe nuk është arritur ndonjë pajtim sikur edhe për temat e mëparme.

Qëndrimet e Delegacionit të Kosovës lidhur me aspektet e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, historike dhe religjioze janë fundamentalisht të mbështetura në dokumentet ndërkombëtare dhe në parimet e UNESCO-s mbi mbrojtjen e këtyre monumenteve.

Problem i veçantë në vazhdimësi është shtruar çështja e krijimit të zonave mbrojtëse rreth këtyre monumenteve. Delegacioni i Kosovës ka shtruar propozimin se ky parim mund të aplikohet për 14 kisha dhe manastire ortodokse serbe. Me këtë rast ka përcaktuar edhe hapësirat e mundshme mbrojtëse të cilat nuk mund të çenojnë në asnjë mënyrë pronën private përreth tyre, por që megjithatë me ligj të veçantë duhet të përcaktohet mënyra e mbrojtjes së tyre. Propozimet e palës serbe në mënyrën se si i kanë shtruar ata (40 objekte dhe hapësira me qindra hektarë përreth tyre) janë të papranueshme.

Lidhur me të gjitha këto tema të shtruara Delegacioni i Kosovës duke pasur parasyshë dokumentin themelor që i ka ofruar për bisedime i është përmbajtur dhe do t'i përmbahet parimit se 'nuk ka marrëveshje përderisa nuk ka marrëveshje të përgjithshme' që nënkupton realizimin e pavarësisë dhe sovranitetit të plotë të shtetit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të theksoj se në kuadër të kësaj periudhe kohore të zhvillimit të këtij procesi kam pasur nderin e veçantë që së bashku me Kryeministrin e Kosovës z. Çeku të kemi takim të rëndësishëm me Sekretaren e Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës znj. Dr. Condoleza Rice, si dhe zyrtarë tjerë të State Department dhe Shtëpisë së Bardhë. Me këtë rast ne jemi inkurajuar dhe mbështetur për qasjet që kemi për ndërtimin e një Kosove demokratike që do të ketë kujdes të veçantë edhe ndaj minoriteteve në kuadër të saj. Përfaqësuesve të shtetit amerikan ua kemi prezantuar qëndrimin e institucioneve dhe popullit të Kosovës për pavarësinë e Kosovës si zgjedhje e pa alternativë që buron nga vullneti i popullit.

Pas pak ditësh kam qenë i ftuar nga ana e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që në emër të popullit dhe të institucioneve të Kosovës të shprehi vizionin tonë për të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës. Me këtë rast shkëlqesisë së tyre, përfaqësuesve të përhershëm të vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit, ua kam shprehur qartazi qëndrimin tonë të palëkundur për realizimin e pavarësisë së plotë të Kosovës, dhe në të njejtën kohë u kam ofruar vizionin tonë për të ardhmen e përbashkët të të gjithë qytetarëve të saj, të shumicës dhe të pakicës.

Të nderuar deputetë,

Duke respektuar përcaktimin tonë për të qenë pjesë aktive dhe konstruktive e të gjithë procesit të bisedimeve, me datën 24 të këtij muaji me ftesë të Presidentit Ahtisari Delegacioni i Kosovës, në bazë të vendimit unanim të të gjithë anëtarëve, ka marrë pjesë në një takim të organizuar nga ai dhe ekipi i tij (UNOSEK) në të cilin kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Grupit të Kontaktit, përfaqësuesit e SHBA-së dhe të Unionit Evropian. Në këtë takim, ku ka marrë pjesë edhe Delegacioni i Serbisë, është hapur çështja e statusit politik të Kosovës.

Ju bëj me dije se qëndrimi i Delegacionit të Kosovës i shprehur në këtë takim ka qenë dhe mbetet prezantimi i vullnetit politik të Kosovës për pavarësinë dhe sovranitetin e plotë të Kosovës. Këtë qëndrim e kemi shprehur duke respektuar pokështu në plotëni qëndrimet e Kuvendit të Kosovës të shprehur përmes Rezolutës së tij se 'pavarësia e Kosovës është e panegociushme'. Me këtë rast ju njoftoj se përmes prezantimit të përgjithshëm me fokus të veçantë për nevojën e përfundimit sa më të shpejtë të këtij procesi me pavarësimin e Kosovës dhe njohjen e saj ndërkombëtare, po kështu përmes debatit të mëvonshëm kemi kundërshtuar me argumente qasjet që përfaqësuesit e Serbisë i kanë ofruar për të ardhmen e Kosovës dhe pozitën e saj juridike-politike, në formë të autonomisë, apo siç ata shpesh herë e propagojnë 'më shumë autonomi e më pak se pavarësi'.

Është e qartë se nuk jemi përputhur dhe as që mund të përputhemi asnjëherë me vizione të tilla. Potencoj me këtë rast atë që e theksova edhe në takimin e Vjenës sikur që kanë theksuar edhe anëtarët e tjerë të delegacionit se konceptet e Prishtinës dhe Beogradit, mund të kuptohen edhe kësisoj: Serbia dëshiron që të na qeverisë dhe të vazhdojë sundimin e tij kolonial në Kosovë, ndërsa Kosova dëshiron që populli i saj të qeverisë me vetëvehten.

Të nderuar deputetë,

Një theks të veçantë, përveç evidencimit të gjithë rrugëtimit tonë për liri dhe pavarësi të përcjellur me ngjarje të përgjakshme përgjatë dekadave dhe veçanërisht me gjenocidin e v. 1999 ndaj popullit shumicë të Kosovës, ia kemi përkushtuar vendosmërisë sonë për të ndërtuar një shtet modern dhe demokratik që në të njejtën kohë do të thotë paqe dhe stabilitet afatgjatë në të gjithë rajonin.

Nevoja jonë e veçantë e cila është prezantuar është pikërisht respektimi i vlerave dhe specifikave të secilës etni që është në Kosovë, me theks të veçantë të pakicave, mbi bazë të standardeve më të larta ndërkombëtare. Me këtë rast i kemi bërë thirrje Beogradit që të ndërprejë instrumentimin e vazhdueshëm të serbëve të Kosovës dhe të lejojë integrimin e tyre në institucionet demokratike të Kosovës. Dhe, po të njejtën kohë ua kemi bërë me dije se karshi nevojës që ata të jenë në rrugëtim bashkë me ne dhe të ndërprejnë bojkotet, megjithatë Kosovës s'mund të jetë peng i sjelljeve të tyre në ecjen e saj përpara.

Delegacioni i Kosovës ka shprehur përkushtimin e tij të veçantë të nevojës së bashkëpunimit me të gjithë fqinjët e vet, pra edhe me Serbinë, dhe vendet e rajonit për të nxitur proceset e gjithanshme të integritimit Kosovës, por edhe të tyre në strukturat e Bashkimit Evropian dhe NATO.

Të nderuar deputetë,

Delegacioni i Kosovës në Vjenë, në unitet të plotë dhe palëkundshëm, ka shprehur përcaktimin e vet për një Kosovë evropiane në miqësi të përherëshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kemi theksuar se historia jonë është e dhimbshme, e përgjakshme. Se nuk mund ta harrojmë këtë histori, por poashtu se jemi të vendosur që të mos mposhtemi prej saj, se vizioni ynë për shtet të pavarur dhe shoqëri multientike, është vizion i përbashkët i institucioneve demokratike të Kosovës dhe i popullit tonë.

Dua t'ju informoj se gjatë drekës kam zhvilluar një bisedë të shkurtër me Presidentin e Serbisë z. Tadic, të cilit ia kam shprehur sërish qëndrimet tona për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës.

Delegacioni i Kosovës është i përkushtuar që të kontribuojë maksimalisht me qasjet e tij konstruktive në mënyrë që procesi për definimin e statusit politik të Kosovës të përmbyllet këtë vit. Për këtë arsye ne do të bashkëpunojmë ngushtë me Presidentin Ahtisari dhe ekipin e tij, me Grupin e Kontaktit dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë, në interes të përshpejtimit të këtij procesi.

Siç jeni në dijeni, po atë ditë Grupi i Kontaktit ka miratuar një dokument të rëndësishëm që vlerëson lartë qasjen e deritashme të Delegacionit të Kosovës dhe inkurajimin për proceset në vijim, duke qenë i përkushtuar poashtu në mbetjen besnik ndaj përimëve të mëhershme lidhur me Kosovën. Theks i veçantë i përkushtohet garantimit të tërësisë territoriale të Kosovës.

Së fundi, të nderuar deputetë ju falënderoj për mbështetjen e përgjithshme që i keni dhënë punës së Delegacionit për realizimin sa më të shpejtë të qëllimit të përbashkët që kemi: pavarësimin dhe sovranitetin e plotë të Kosovës.

Pokështu falënderoj angazhimin e institucioneve ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, mekanizmat e tyre civilë dhe ushtarakë (KFOR dhe policinë e UNMIK-ut) për ndihmën e madhe që i kanë ofruar popullit dhe institucioneve të Kosovës përgjatë këtyre shtatë viteve, si dhe kontributin e tyre për përmbylljen e këtij procesi.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. president për këtë informatë autentike për takimin e Vjenës.

Vazhdojmë me diskutimet rreth pikës së katërt të rendit të ditës. Për fjalë është paraqitur Naxhije Doçi.

DEPUTETJA NAXHIJE DOÇI – I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra, deputetë të nderuar.

Para se të filloj të jap mendimin tim për këtë projektligj do të kisha cekur që edhe në vlerësimin e mëparshëm që e kam bërë në lidhje me arkivat dhe lëndën arkivore, punimin të cilin në marrëveshje me Kryesinë dhe në marrëveshje me teknikën nuk e kam parë në transkript, kështu që kisha dëshiruar megjithatë të përfshihet në transkript ky vlerësim.

Në vlerësimin për projektligjin në fjalë do të kisha cekur kësisoji: Tashmë e dimë se Projektligji për trashëgiminë kulturore ka kaluar në disa lexime, si në legjislacionin e parë, po ashtu edhe në legjislacionin e dytë dhe se gjatë kësaj kohe janë bërë vlerësime të shumta dhe të dobishme nga deputetët. Përkundër punës së kryer, fati i këtij projektligji ka mbetur ende i padefinuar, pra ende nuk është bërë miratimi i këtij projektligji për ta marrë formën e kënaqshme për rolin që duhet ta ketë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Duke qenë të vetëdijshëm se një projektligj i tillë është më se i domosdoshëm për ne në këto rrethana, para statusit final të Kosovës si dhe duke qenë të vetëdijshëm se ligji është edhe një standard shumë i kërkuar dhe vendimtar për ne, mendoj se duhet të miratohet domosdoshmërisht. Me respektin e madh në favor të miratimit të këtij projektligji do t'i kisha cekur edhe disa plotësime që mendoj se janë të rëndësishme që do ta begatonin përmbajtjen sa i përket konkretizimit dhe precizimit të periudhave kohore në begatinë kulturore të Kosovës. Sa i përket ruajtjes së trashëgimisë kulturore në Kosovë dihet se gjatë gjithë periudhës të paraluftës së fundit 1998 – 1999, është fjala për shekuj të tërë nuk është ruajtur si duhet trashëgimia kulturore. Monomentet historike, sidomos gjetjet arkeologjike ose janë tjetërsuar ose kanë humbur krejtësisht këtë pasuri e sidomos ato me mbishkrime apo me vlerë ari apo argjendi si dhe argjili i kanë marrë dhe i kanë dërgaur në Beograd apo gjetiu nëpër qendrra të tjera që nuk i dijmë se ku. P.sh në Runik të Drenicës, në Therandë në vendin e quajtur Hisari në Grajqevc të Therandës, në kalanë e quajtur Gjyteti, në Gradinë të Kotorrit të Drenicës etj. Vetë fshatarët thonë se kanë marrë ankititetet me kamion dhe i kanë dërgaur në Beograd. Këtë e them nga se gjatë mbledhjes së materialit për dhunën serebe gjatë dhjetëvjetëshit të gjendjes së luftës dhe sidomos gjatë luftës 97, 98, 99 mbi populltën shqiptare, sidomos ndaj femrës shqiptare që i kam mbledhur në librin tim të botuar me titull “..... i dërmuar” banorët e vendeve të cekura, por edhe të tjerat që nuk janë cekur vetë kanë thënë se dhuna serbe nuk është bërë vetëm në njerëz, por edhe në kulturën dhe

në trashëgiminë tonë kulturore. Duhet të dimë dhe t'i mbrojmë varret e shumta nëpër Kosovë që janë zakonisht me gurë apo me rrasa të mëdha dhe që quhen Varret e Murtajës, Varret e Krushqve etj, sepse kanë rëndësinë e vet, pra të mbrohen me nen të veçantë. Kur e dimë se gjatë sundimiti serb në Kosovë çështja e kulturës ilire është shtrembëruar ose me qëllim është marrë si romake e bizantine, mendoj se është e domosdoshme që të konkretizohet. Këtë po e them edhe mbi bazën e bisedës që e kemi pasur gjatë kohës që e kemi pasur në Komisionin për Arsim dhe një propozim të tillë e kam parë se ka hasur në mirëkuptim edhe nga ndërkombëtarë që ka qenë prezentë në këtë Komision dhe që ka kërkuar që vërtet të precizohet periudha ilire që është e mangët në këtë projektligj. Që të jemi më të sigurt dhe më konkret duhet të këto gjëra nëse duam t'i kemi si duhet duhet t'i favorizojmë dijetarët shqiptarë, shkencëtarët shqiptarë dhe të huaj për të përcaktuar këto çështjes antike, mesjetare etj, pra të përcaktohen periudhat kohore që ligji të jetë në nivel dhe që ajo të jetë një përshkrim i vet parahistorisë dhe historisë tonë që është më se i domosdoshëm, kur e dimë se popullata në Kosovë shqiptare është 90% dhe është trashëgimi reale jona, pasuri kulturore e Kosovës, duhet paraparë në mbrojtje edhe gjëmat dhe kështjellave ilire që nuk janë të pakta nëpër Kosovë. Marrë në përgjithësi kemi pasuri të mëdha të trashëgimisë kulturore që duhet konzervuar dhe ruajtur si sytë e ballit e jo vetëm kishat, xhamitë edhe pse edhe ato janë tonat. Në mbrojtje mendoj se duhet të parashihen edhe varret edhe të mëhereshme, por edhe të kohës më të re, p.sh, varret e Jasharajve, varri i Idriz Seferit, i Haxhi Zekës, të sillen eshtrat e Isa Boletinit me shokë nga Podgorica, varri i Ymer Prizrenit, varri i Hasan Prishtinës etj dhe këto të mbrohen me ligj dhe nene të posaçme nëse duam vërtet që ta kemi një kulturë që do të krenohemi nesër me te. Në nenin 6 faqe 16 theksohet se trashëgimia arkitekturale daton prej parahistorisë deri në kohën e tashme. Mendoj se në këtë duhet shtuar se kjo trashëgimi u përket periudhave së pari ilire e pastaj me radhë se si janë bërë pushtimet, romake, bizantine, sllave, osmanoturke etj. Sidomos te neni 7 ku parashihet trashëgimia arkeologjike në faqën 19 dhe rezervat arkeologjike në faqën 21 duhet paraparë gjetjet arkeologjike antike ilire, sepse kanë të bëjnë me të parët tanë ilirët. Së fundi do të kisha cekur se në aspektin gjuhësor dhe sintaksor, por edhe në atë përmbajtësor ky ligj ka mangësi, andaj është më se e domosdoshme që nëse duam kulturë, atëherë edhe kulturën e gjuhës ta respektojmë, kuptueshmërinë e ligjit, sepse kjo është vetë kultura jonë. Edhe një herë po e ceku se Projektligjin e përkrahi në parim dhe duhet të miratohet, por normal mos t'i harrojmë periudhat ilire sepse janë tonat. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ragip Zekolli.

DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI – Faleminderit z. kryetar. Unë do t'i them disa gjëra që janë konkretisht të lidhura me çështjen e Ligjit dhe vërtet është imedijate dhe e domosdoshme që sa më shpejt të kalojë si është biseduar. Te neni 2.20 do të ishte mirë gjithsesi që të shtrohej për shpjegim edhe një term tjetër si vjen i pakuptimt -zona mbrojtëse. Është fjala për shtresën kulturore, aty ku janë bërë gjëmat arkeologjike apo ndodhet monamenti i kohës së caktuar. Një çështje tjetër te neni 4.1 neni 4.2, 4.3 ndoshta është mirë për fjalën “asetet” të gjejmë një shprehje tonën që mund të jetë pasuria apo diçka e kësaj natyre, sepse vërtet shpesh po i marrim si fjalë të huaja dhe në një formë është pak vështirë të kuptohet në kuptimin e përgjithshëm. Te neni 6.9 që mendoj se duhet të jetë në harmoi me nenin 7.17, 7.20, 7.2, sepse flitet për afatet kohore brenda

neneve të caktuara që palët e caktuara duhet të zgjidhin çështjet në Ministri, andaj këtu flitet për afate 15 ditëshe, 20 ditëshe, 30- ditëshe dhe me qenë se është fjala për një ligj është mirë që këto të jenë të miratuara në komisionin funksional me një afat qoftë 30 apo 20, por jo për njënin 30 e për tjetrin në forma të ndryshme. Ndërsa kur është fjala për gjetjet arkeologjike ,që t' ju than të drejtën te fjala shqip përmendet ende "përmenda", kurse në serbisht përmendet "pllugu" e kështu me radhë që shpesh kanë qenë më të shpeshta edhe më të shpejta se vetë dora e njeriut dhe është shkatërruar një pjesë e trashëgimisë kulturore dhe kjo është mirë është që të unifikohet. Një gjë tjetër, çka mendoj se është në interes të ligjit dhe në interes të përgjithshëm është te neni 7.32 ku thuhet për gjërat e gjetura nga hulumtimet arkeologjike që ato ekspozohen dhe publikohen do të ishte mirë gjithsesi që të thuhet edhe të ruhen, sepse një pjesë e tyre në muzet tona janë në gjendje shumë të rëndë. Unë me keqardhje mund të them se e kamë vizituar Muzeun e Kosovës dhe kam vërejtur që ato ekspozate i janë nënshtruar lagështisë dhe gjërave të tjera. Dhe krejt në fund dua që të shtroj edhe një çështje ,që vërtet shpesh po e përmendim, mirëpo është mirë të konkretizohet njëherë apo të kemi përgjegjësi për çështjen e gjuhës, neni 9.15 Ministria do të jetë përgjegjëse, d.m.th "do të jetë" të le të kuptohet diçka që në ligj nuk është në rregull dhe është mirë të thuhet "është përgjegjëse" për çështje të tilla. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – Z. kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë. Unë mbështes miratimin sa më të shpejtë të këtij projektligji dhe përgëzoj Ministrinë për harmonizimin e qëndrimeve edhe në Këshillin e Evropës edhe me kompetentët e tjerë. Mirëpo ajo që është e rëndësishme na mbetet për t'u bërë në të ardhmen lidhur me këtë ligj dhe çka në të vërtet është, besoj se kemi një obligim të veçantë për ta implementuar ligjin të gjithë së bashku në kuptim të financimit dhe të asaj që parashihet brenda ligjit. Kjo do të thotë që edhe ne si Kuvend edhe Qeveria e Kosovës të kemi një përkujdesje më të shtuar me rastin e miratimit të buxhetit dhe për të ndarë fonde të veçanta për zhvillimin e kulturës në Kosovë në përgjithësi dhe në veçanti për zhvillimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore. Ta kemi parasysh në procedurat e ardhshme dhe në momentin kur do ta miratojmë buxhetin të mos harrojmë atë që sot po e themi. Dhe e dyta, falënderoj komunitetin ndërkombëtar për ndihmën që e ka dhënë në ruajtjen e fushës së trashëgimisë kulturore,pra, i ftoj përsëri që të vazhdojnë në këtë drejtim, duke u nisur nga mundësitë tona për të bashkëpunuar me të. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Faleminderit z. kryetar, përfaqësues të Qeverisë dhe ju kolegë deputetë. E kam kërkuar shumë herët fjalën, por nuk e di pse s'mu dha. Unë këtu nuk e kam ndërmend të bisedoj as për elefantë as për gjela që grinden, por për ligjin. Vendi ynë, si pak vende në botë është me një trashëgimi të jashtëzakonshme kulturore që nga parahistoria, antika e këndeje, andaj ky ligj është i një rëndësie të madhe, por ky ligj dhe kjo fushë në përgjithësi për arsye të statusit të ardhshëm të vendit është politizuar, andaj ligjet e tilla po hartohen e rihartohen disa herë. Ky model nuk e ka asnjë shembull të ligjeve që zbatohen sot në shtetet e ndryshme. Propozuesi i ligjit është mirë

edhe një herë të na shpjegojë këtu se në çka është bazuar forma e organizimit të ligjit e përcaktuar me të, sepse Projektligji dhe memorandumit që u lexuan këtu nuk mjaftojnë për këtë, pra nuk garantojnë trajtimin më të mirë të trashëgimisë kulturore të Kosovës. Institucionet profesionale shkencore, si Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monamenteve, Instituti Arkeologjik, Muzeu i Kosovës etj, nuk u është përshkruar asgjë. Me ligj, të gjitha janë lënë nën kompetencën e Ministrisë dhe të ministrit, veçanërisht të Këshillit për trashëgiminë kulturore. Të ndalemi rreth Këshillit për Trashëgiminë Kulturore. Neni 4.8 thotë: "Anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore do të jenë përfaqësues të etnive të ndryshme dhe interesave sektoriale dhe gjithashtu do të përmbajnë ekspertizë ndërkombëtare" do të thotë ekspertiza vendore këtu nuk parashihet. Ky këshill nuk parashihet të ketë kritere profesionale shkencore, por më tepër përmenden kritere politike dhe kritere strukturore. Këtij këshilli njëkohësisht i janë dhënë edhe kompetenca legjislative e ekzekutive që i defaktorizojnë institucionet profesionale shkencore. Paraprakisht me këtë ligj do të krijoheshin kushtet për përzierje dhe përplasje të kompetencave. Ky këshill në fakt është vetë ligji, sepse ligji nuk është ky, por është Këshilli, ky është ligji, sepse ky krejt kompetencat i ka marrë. Me këtë ligj në fakt askush nuk është ligj dhe zot i trashëgimisë kulturore, pos këtij këshilli politik për trashëgiminë kulturore. E gjithë kjo formë është bërë me qëllim që edhe me këtë ligj të vërtetohen si interes i trashëgimisë kulturore, zonat e mbrojtura për qëllime politike që i ka caktuar e do t'i caktojë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, rreth monamenteve mesjetare të kultit. Fare në fund dua të them edhe këtë se në ligj duhet të qartësohet edhe çështja e dhënies së të drejtës që organizatat joqeveritare të kenë në pronësi koleksione publike të trashëgimisë së luajtshme. Këtu lihet shumë vend për interpretime dhe rrjedhje të trashëgimisë kulturore në kundërshtim me interesin e trashëgimisë kulturore të Kosovës në kundërshtim me interesin e interesit të trashëgimisë kulturore të vendit. Me largimin e këtyre të metave gjatë përpunimit këto gjithsesi duhet të heqen, në të kundërtën nuk do ta kishte mbështetjen e subjektit që unë e përfaqësoj Lëvizjes Popullore të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka Çibrije Hoxha, është diskutuesja e fundit. Lus deputetët që janë jashtë sallës të kthehen në sallë.

DEPUTETJA ÇIBRIJE HOXHA – Ju faleminderit z. kryetar. Pajtohem me të gjithë parafolësit e mi se ky projektligj është punuar mirë dhe jam natyrisht për miratimin e tij në parim. Këtë po e them edhe për arsye se ky projektligj ishte në pajtueshmëri me konventën e UNESCO-s të marrë më 16 nntor 1972 në Paris dhe në këtë konventë trashëgimia kulturore e një vendi konsiderohet si trashëgimi e përbashkët kulturore e të gjitha kombeve dhe prapë kjo konventë e UNESCO-s angazhohet dhe investon për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në gjithë botën si trashëgimi e përbashkët e njerëzimit. Së këndemi mendoj se këtë projektligj do ta begatonte një normë juridike brenda ligjit ku do të definohet edhe bashkëpunimi me UNESCO-n si subjekt ndërkombëtar që merret me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Lus deputetët që nuk janë në sallë të kthehen në sallë se do të votojmë. Në sallë aktualisht janë 64 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatitemi për votim.

Votojmë tash:

Për 58

Kundër..... 3

Kalon miratimi i Projektligjit në parim.

Kalojmë në pikën e 5- të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe me derivatet e naftës në Kosovë.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 6 korrik 2006 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore do t'i adresohen Komisionit Funkcional Përgjegjës për raportim, si dhe komisioneve kryesore. Ftohet zëvendësministri ,z. Kryeziu, ta prezantojë Projektligjin.

ZËVENDËSMINISTRI KADRI KRYEZIU – I nderuar kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra. Me këtë ekspozë do t'i paraqes qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen për ndryshimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë.

Projektligji për ndryshimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës ka për qëllim të sigurojë ndryshimet e nevojshme në Ligjin për tregti me naftë dhe derivate të naftës me çka do të krijohen kushte për aplikueshmëri të plotë të ligjit. Ligji Nr. është miratuar në Kuvendin e nënshkruar sipas Rregullores 07 maj 2005 nga Përfaqësuesi e OKB-së.

2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës Kosovës ëe 22 prill 2005 dhe është së 17NMIK-ut Nr. 2005/22 me datën Special i Sekretarit të Përhershëm

Projektligji ka për qëllim t'i definojë ndryshimet që konsistojnë në eliminimin e paqartësive në rolin e ushtrimit të kompetencave ndërmjet Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë dhe Ministrisë së Transportit dhe Postë Telekomunikacionit. Ndryshimet në Ligjin për tregti me naftë dhe derivate të saj, do të ndikojnë në rritjen e bashkëpunimit dhe të sinkronizimit të punëve dhe të detyrave të të dy ministrive.

Ligji për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës është harmonizuar me Ligjet tjera në fuqi andaj edhe ndryshimet në këtë ligj u janë përshtatur rrethanave në Kosovë.

Projektligji për ndryshimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë për nga gjerësia e rregullimit të kësaj fushe, është strukturuar në gjithsej: tetë nene, në të cilat janë paraparë të bëhen ndryshimet.

Në nenin 1 paragrafi 1.2 fshihet fjala: "transport"

Në nenin 4 paragrafi 4.1 fshihen fjala: "transport"

Në nenin 4 paragrafi 2. pika (b) të fshihet: fjala "transportoj "

Në nenin 4 paragrafi 4.2 pika (c) fshihet në tërësi

Në nenin 4 paragrafi 4.2 pika (f) të fshihet fjala: "Transportin"

Në nenin 4 paragrafi 4.6 fshihet fjala: "transportojnë dhe"

Në nenin 5 paragrafi 5.2 pika (d) fshihet në tërësi.

Të nderuar deputetë,

Duke e pasur parasysh rëndësinë e rregullimit juridik të kësaj fushe, themi se është vitale për ndërtimin e një ekonomie formale në Kosovë të bazuar në parimet e ekonomisë së tregut. Ky projektligj do të vendoste një rregull ligjor për sa i përket fushës së sektorit të naftë në Kosovë. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor të fushës së ekonomisë në përgjithësi, ju rekomandoj që këtë projektligj ta shqyrtoni dhe ta miratoni në këtë seancë parlamentare.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibush Jonuzi.

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Faleminderit z. kryetar. Ministra të nderuar, zëvendësministra dhe deputetë të respektuar. Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së të paraqes qëndrimet për Projektligjin për ndryshimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës. Inisiativën për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji e ka paraqitur Ministria e Transportit dhe Postelekomunikacionit. Ligji për tregtinë e naftës dhe të produktve të saj (në tekstin vijues: Ligji) rregullon ndër të tjeera transportin e naftës dhe të derivateve të saj. Në veçanti për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të naftës dhe derivateve të saj nevojitet licenca e lëshuar nga Këshilli që është organ në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë (shih nenet 4.1 dhe 4.2 të Ligjit) Në anën tjetër Ligji për transportin e mallrave të rrezikshme parashikon që asnjë person nuk mund të merret me transportin e mallrave të rrezikshme pa licencën e lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Postelekomunikacionit. Neni 6 i Ligjit për transportin e mallrave të rrezikshme, në bazë të përkufizimeve të Marrëveshjes Evropiane për transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë tokësore ADR së cilës I referohet Ligji për transportin e mallrave të rrezikshme (nafta dhe derivateve të saj) konsiderohen si mallra të rrezikshme. Nga kjo del se sipas këtij ligji transportuesi i naftës dhe i derivateve të saj duhet të ketë licencë të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe e Postelekomunikacionit. Nga dispozitat e mësipërme mund të konkludohet se personat që duan të merren me transportin e naftës dhe të derivateve të saj i nënshtrohen detyrimit ligjor për të marrë dy licenca nga ministrit e ndryshme dhe në bazë të dy ligjeve të ndryshme për ta fituar të drejtën e ushtrimit veprimtarisë në fjalë. Ndryshimet që i propozon Qeveria në projektligj kanë për qëllim harmonizimin e Ligjit për tregtinë e naftës dhe produktet e saj me Ligjin për transportin e mallrave të rrezikshme. Qeveria synon ta arrijë këtë qëllim duke eliminuar detyrimin ligjor për transportuesit e naftës dhe derivateve të saj të pajisur me licenca nga Këshilli që funksionin në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe duke paraparë, kështu që për këtë veprimtari të kërkohet vetëm licenca nga Ministria e Transportit dhe e Postelekomunikacionit në bazë të Ligjit për transportin e mallrave të rrezikshme, prandaj parasheh shlyerjen e transportit nga neni 1.2, 4.1, 4.2 nën (b)

dhe (c) pastaj 4.6 dhe 5.2 nën (d) të Ligjet për tregtinë e naftës dhe produktet e saj. Mirëpo ndryshimet e propozuara nga Qeveria në këtë formë shkaktojnë zbrastësi ligjore. Sipas përkufizimit të termit transport në nenin 2 të Ligjit për tregtinë e naftës dhe derivateve të saj, me transport nënkuptohet bartja me anë të gypave, hekurudhës ose automjeteve. Ligji për transportin e mallrave të rrezikshme rregullon vetëm transportin në rrugë tokësore dhe hekurudhore (neni 3) në këtë nëse hiqet termi transport nga Ligji për tregtinë e naftës dhe produkteve të saj bartja e naftës dhe derivateve të saj nëpërmjet gypave do të mund të bëhet pa licencë, sepse kjo veprimtari nuk mbulohet nga Ligji për transportin e mallrave të rrezikshme. Për të evituar këtë zbrastësi ligjore propozoj që Këshilli, Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë të vazhdojë me dhënie të licencës të bartjes së naftës dhe të derivateve të saj nëpërmjet gypave deri sa kjo çështje të rregullohet me ligj të veçantë, ndërsa licencimin e transportuesve të naftës dhe të derivateve të saj nëpërmjet automjeteve, hekurudhës ta bëjë Ministria e Transportit dhe Postelekomunikacionit. Në aspektin teknik- juridik harmonizimi ndërmjet dy ligjeve në fjalë mund të bëhet thjesht duke ndryshuar vetëm përkufizimin e termit transport në nenin 2 të Ligjit për tregtinë e naftës dhe të produkteve të saj.

Transporti a bartja e naftës dhe e derivateve të saj nëpërmjet gypave, duke kërkuar kështu bartjen e naftës dhe derivateve të saj nëpërmjet automjeteve dhe hekurudhës nga fushëveprimi I ligjit për tregtinë e naftës dhe të produkteve të saj. Nëse bëhet ky ndryshim nuk ka nevojë për heqjen e termit "transport", siç e ka propozuar Ministria, mirëpo atëherë termi "transport" në tërë ligjin do ta kishte kuptimin e bartjes së naftës dhe derivateve të saj vetëm nëpërmjet gypave. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së në parim e përkrah projektligjin në fjalë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj në emër të AAK-së.

DEPUTETI XHEVDETE NEZIRAJ – I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë. Edhe Grupi Parlamentar i AAK-së përkrah ndryshimet në Ligjin 2004/5 për tregtinë e naftës dhe këtu ka të bëjë vetëm me mënyrën dhe metodën e transportit për mosporzierjen e kompetencave ndërmjet të Ligjit për transportin e mallrave të rrezikshme dhe të tregtisë me naftë, prandaj është një ndryshim që do të jetë shumë më i zbatueshëm, prandaj Grupi Parlamentar i përkrah këto ndryshime. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Pasi që nuk ka më të interesuar për diskutim, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Në sallë janë 61 deputetë.

Votojmë tash:

Për 59

Kundër0

Kalon propozimi. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e 7- të rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parqet nacionale.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 6 korrik të vitit 2006 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Ftoj ministrin ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI ARDIAN GJINI - I nderuar z. kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Më lejoni që sot para jush ta paraqes Projektligjin për parqet nacionale të Kosovës. Ligji i ka disa qëllime. Qëllimi i parë është mbrojtja dhe shtimi i vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Kosovë, promovimi dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i të mirave të natyrës së Kosovës, përmbushja e të drejtave të qytetarit për jetë, mjedis të shëndosë dhe në fund është qëllimi i promovimit dhe i zhvillimit socio-ekonomik të komunitetit në parqet nacionale. Ministra e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i ka bërë të gjitha studimet e nevojshme për të arritur deri në hartimin e këtij ligji. Ky ligj do të mbulojë dy parqe nacionale. Malet e Sharit, park i cili me ligj të aplikueshëm është i shpallur dhe që mbulon 39.000 hektarë të territorit të Kosovës, ndërsa parku tjetër do të jetë Bjeshkët e Nemuna, që do të shpallet me këtë ligj dhe që do të mbulojë 62.000 hektarë të territorit të Kosovës. Ligji përmban 39 nene, 8 kapituj. Kufijt e parqeve nacionale janë të definuar në këtë ligj dhe po ashtu edhe hartat topografike dhe kadastrale i janë bashkangjitur ligjit. Në lidhje me ligjin është biseduar mjaft në të kaluarën dhe çështjet që kanë qenë më tepër të diskutueshme kanë qenë lloji i pronave dhe administrimi i tyre, qofshin private ose publike në parqet nacionale. Në lidhje me këtë unë kisha dashur ta përqendrojë vëmendjen tuaj në nenet 11 dhe 12. Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, nëpërmjet këtyre neneve Ministria ka synuar të rregullojë çështjen e administrimit dhe të shfrytëzimit të pronës private në parqet nacionale. Qëllimi i neneve është ky që në cilindo vend ku zonat e parkut nacional nuk e lejojnë shfrytëzimin e pronës nga pronarët, në mënyrën si ata dëshirojnë, mirëpo edhe këtë herë Ministria dhe Qeveria e Kosovës do të gjejnë mënyra që të kompenzohet vlera e humbur e përfitimeve materiale që qytetarët e Kosovës mund t'i pësojnë. Kjo mund të ndodhë në disa raste edhe pse i është kushtuar shumë kujdes që gjatë zonimit prona private kryesisht gjendet në zonën e dytë ose të tretë të parqeve nacionale, ndërsa në zonën e parë - ku mbrojtja është strikt - të gjendet kryesisht pronë publike. Në rast se ndodh që të ketë edhe pronë private në zonën e parë ku do të ketë mbrojtje strikte, atëherë duhet të gjejmë mënyra që përpos shfrytëzimit të pronës që do ta kenë qytetarët e Kosovës në atë zonë duhet të gjenden mënyra që të kompenzohen për ndonjë rast eventual ku ata nuk mund të shfrytëzojnë pronën në mënyrën si duan vetë.

Do të jenë 3 zona. Zona e parë është **strikt- zonë**, në të cilën nuk lejohet kurfarë intervendimi në pronë as në trashëgiminë natyrore e as në tjetrën. Zona e dytë është zona ku lejohet intervenimi i pjesshëm, qoftë për mbrojtje kultivim ose për arsye të tjera, ndërsa zona e tretë në parqet nacionale do të jetë zonë në të cilën lejohen intervenime, lejohen ndërtime, qoftë për rekreacion ose për aktivitete industriale që u përgjigjen rrethanave në parqet nacionale, do të thotë përpunimi i produkteve blegtorale e përpunimi i produkteve bujqësore natyrore të malit.

Unë do t'i ftoja deputetët e Kuvendit të Kosovës që për të gjitha këto arsye, me qëllim të mbrojtjes së trashëgimisë natyrore, me qëllim të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe me qëllim të ofrimit të trashëgimisë natyrore të Kosovës, të bukurive të natyrës së Kosovës për qytetarët e Kosovës dhe në të njëjtën kohë për mbrojtjen dhe shfrytëzimin sa më afatgjatë të mundshëm të kësaj, sot ta miratojmë në parim këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit ministër. Fjalën e ka deputeti Shaban Halimi.

DEPUTETI SHABAN HALIMI – I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë. Grupi Parlamentar i LDK-së, duke pasur parasysh sugjerimet e anëtarëve të Komisionit Funkcional të LDK-së lidhur me ligjin në fjalë jep votën e vet për leximin e parë me qëllim që t'i hapet rrugë për punë të mëtejshme këtij ligji. Lidhur me rolin dhe rëndësinë e këtij ligji për parqet nacionale, besoj se është e mjaftueshme ajo që e tha z. ministër dhe njëherit ajo që na është ofruar në tekstin e këtij projektligji. Gjithashtu neve, si anëtarë të Komisionit Funkcional të LDK-së kemi vërejtjet dhe sygjerimet në këtë ligj për të cilat mendojmë se janë të tejkaloeshme dhe të riparueshme në punën e mëtejshme që duhet të bëhet nëpër komisionet funksionale e sigurisht edhe në dëgjimet publike. Vërejtja esenciale që mund t'i bëhet ligjit është ajo se ai për parqet nacionale definon vetëm dy parqe nacionale, Malet e Sharit dhe Bjeshkët e Nemuna. Njëri me një ligj të vitit 86, kurse parku i dytë nacional me ligjin në fuqi. Në këtë drejtim në përmbajtjen e ligjit nuk janë të parapara kriteret për shpalljen e parqeve nacionale, gjë që bie ndesh me disa nene të këtij ligji siç është neni 1, që në bazë të këtij ligji mund të shpallen edhe parqe të tjera nacionale që janë me interes për qytetarët dhe në këtë drejtim ligjit i mungojnë kriteret, Shpresojmë që me punën e mëtejshme nëpër komisione dhe dëgjime publike me grupet e interesit dhe të ministrive përkatëse që kanë të bëjnë me këtë ligj se këto pengesa do t'i tejkalojmë. Prandaj Grupi Parlamentar i LDK-së i jep votën e vet për këtij ligji, pro leximit të parë me qëllim që të vazhdojë puna mëtej. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka Selviqe Halimi.

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI – Z. kryetar, të nderuar deputetë. PDK-ja është për Ligjin për parqet nacionale, duke shprehur shqetësimin lidhur me përmbajtjen në nenin 3.11, nenin 7, nenin 5 i cili përcakton kufijt e parqeve nacionale për të cilat flitet në këtë ligj, nenin 8 që krijon kufizimet me nenin 5, pastaj nenet 14, 15, 17 dhe 33. Me qëllim që të mos krijohen keqinterpretime apo të lejohen zbrastësira juridike që do të shkaktojnë probleme gjatë implementimit të këtij ligji në praktikë, mendojmë se gjatë punës në komision do të marrë pjesë edhe sponsori i ligjit dhe të jep fjalën e vet aty se çka ka dashur të thotë në këto nene, sepse këto nene nuk janë kompletuar dhe nuk është bërë një interpretim më i qartë në formë të shkruar. Gjithashtu edhe PDK-ja kërkon që ky nen t'i përcaktojë kriteret se në bazë të cilave duhet të shpallet një park- park nacional, në mënyrë që të lihet mundësia që edhe në të ardhmen të mund të veprojmë në bazë të këtij ligji për shpalljen e parqeve nacionale. D.m.th jemi pro këtij ligji dhe besojmë se gjatë punës në Komision do të kompletohet ky ligj.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Mazlloom Kumnova.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA – Z. kryetar, ministra. Është e njohur se parqet kombëtare kanë vlera unike të trashëgimisë natyrore të një kombi, prandaj edhe emërtohen si parqe kombëtare. Numri i parqeve kombëtare në çdo shtet e tregon edhe përkushtimin e atij shteti për të mbrojtur trashëgiminë e vet natyrore, por edhe të asaj kulturore pa anashkaluar të mirat ekonomike që rrjedhin në këtë drejtim. Sot në botë ka rreth 3800 parqe kombëtare me një sipërfaqe të përgjithshme rreth 4.5 milion kilometra katrorë. Një nga këto është edhe i vetmi park nacional i shpallur deri më tani në Kosovë “Shari”, ndërsa të dytin do ta shpallim ne me miratimin e këtij projektligji. Duke u nisur nga qëllimi i mbrojtjes, i ruajtjes, i zhvillimit, përparimit, shfrytëzimit dhe menaxhimit të vlerave të natyrës në Kosovë, Grupi Parlamentar i AAK-së në këtë Kuvend e ka mirëpritur këtë projektligj nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor. Po ashtu është e njohur një përpjekje për një ligj të tillë vetëm për Bjeshkët e Nemuna ka qenë në mandatin e kaluar të këtij Kuvendi, por për arsye të caktuara nuk arriti të miratohet, duke mos e vlerësuar për dëmin mjaft të madh që i është bërë mbrojtjes së vlerave të natyrës në Bjeshkët e Nemuna, por kjo le të mbetet mësim edhe për ne se si nuk duhet vepruar ndaj vlerave tona. Kjo qasje për një projektligj për parqet kombëtare ndoshta do të jetë më e qëlluar, sepse do të rregulloheshin mbrojtja dhe administrimi i vlerave të natyrës së Bjeshkëve të Nemuna si dhe do ta zhvlerësonte Ligjin për parkun e Sharrit të aplikueshëm nga viti 1987. Në praktikën e sotme parku i Sharrit administrohet nga dy zyra të parkut, njëra në Prizren- nën kompetencat e Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor të Kosovës dhe tjetra në Shterpçë nën administrimin e institucioneve të Beogradit që fatkeqësisht ende e menaxhon pjesën më vitale ekonomikisht të parkut “Brezovica”. Prandaj ky projektligj një herë e përgjithmonë duhet të definojë se kush i menaxhon parqet kombëtare të Kosovës dhe të mirat që vijnë nga këto. Projektligji që e kemi në dorë, i punuar edhe nga ekspertë me përvojë shkencore ndërkombëtare në këtë fushë është mbështetur në konventat ndërkombëtare të mbrojtjes e të diveresitetit dhe të trashëgimisë natyrore, si dhe është harmonizuar me direktivat e BE-së për mbrojtjen e biodiveersitetit, që mund të na sigurojë që këto dy parqe kombëtare të radhiten në listën e parqeve botërore, si dhe të bëhen pjesë e Federatës Evropiane të parqeve “Europark” në një të ardhme dhe rrjetit “Natyra 2000”. Kriteret për çka u fol pak më parë, që duhet të vendosen në këto nene, i shoh të paarsyeshme, meqë janë konventat, s’kemi nevojë të bëjmë përshkrimin e tyre në nene. Jemi të mendimit se titulli i këtij projektligji në gjuhën shqipe duhet të jetë “Ligji për parqet kombëtare”. Duke u nisur nga kërkesat e ngutshme për mbrojtjen e vlerave të natyrës, për zhvillimin dhe përparimin e tyre, Grupi i AAK-së kërkon që t’i jepet përkrahje dhe të shpejtohet procedura e miratimit në Kuvend, sepse degradimi i këtyre vlerave qysh sot është shqetësues së paku do të pengohet për t’i hapur rrugë pastaj zhvillimit të kësaj hapësire pse jo edhe për interesa ekonomike. Gjithashtu ky projektligj dhe shpallja e parqeve nacionale dhe kombëtare ka shansa të mira për realizimin e projekteve rajonale, nisma që kanë filluar në Ministrinë e Mjedisit, në Ministrinë homologe të Shqipërisë dhe të Malit të Zi dhe të Maqedonisë. Deputetë të nderuar, ju ftoj për përkrahje të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju aleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

POSLANIK DŽEZAIR MURATI – Poštovani predsedniče, ja se pridružujem primedbama koje su već date na ovaj N/Z o nacionalnim parkovima i nekoliko posebnihodredbama pomenuo ovde. Možda je greška u prevodu ali se vlastite imenice se nemogu prevediti tako da obe variante moraju ostati u originalima. U varijanti koju ja koristim preveden je naziv. Nacionalni park Shar Planina kako stoji i u predogu N/Z osnovan 1986 godine službenim listom Kosova što se pomenuo ovde ali primedba je u tome da ponovo se ponavlja ono što smo mnogo puta ovde primetili da u radnim grupama u izradi ovog zakona koji zakon po nas ima poseban značaj jer se nalazi u sredini gde žive predstavnici moje zajednice nije učestvovao ni jedan ekspert u izradi u radnoj grupi, pominju se eksperti domaći i strani ali ja ne vidim u ovom spiski stranih eksperata, radi se u solidnom sadržaju teksta zakona ali bih se zadržao na članove 10 i 11, 10 koji predviđa da Skupština opština određene, dakle opštine može doneti odluku o gradnji, šta i koliko je ona u suprotnosti sa odredbama zakona ne stoji to dovoljno i član 11 koji predviđa mere protiv korišćenja privatnog vlasništva kojoe se nalaze na prostore gde se nalazi nacionalni park, nije dovoljno razrađeno, stoji to određena protiv nadoknada u procentu za koji je neko oštećen ali mora malo detaljnije i kada su u pitanju kazne odredbe ja mislim da tu treba još malo dodatno da pojasnimo neke stvari. U celini kažem uz primedbe koje sam naveo da se radi o solidnom tekstu N/Z mi ga na u načelu prihvatamo uz primedbe dodajemo i nadamo da će on uskoro biti potpisan i od strane specialnog predstavnika. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Unë mendoj se sa i përket kufizimit me Malin e Zi në ligj nuk janë dhënë sqarime të qarta se ku do të jetë kufiri me Malin e Zi. Dihet mirëfilli se nga veriu kufiri me Malin e Zi apo prej nesh i bie nga perendimi kufiri me Malin e Zi është zhvendosur prej Çakorrit dhe ka arritur dikund deri 2 kilometra te Kuçishta dhe ka arritur deri gadi në malet e Leçinatit, prandaj duhet të jemi të vëmendshëm sa i përket përcaktimit të kufijëve dhe përkrahimit të tyre me Malin e Z, në mënyrë që të mos krijohen pastaj edhe raporte dhe ngatërresa ndërshtetërore ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, sepse shpeshherë e dimë se ngatërresat ndërshtetërore çojnë edhe deri te konfliktet. Rasti më i mirë ishte para disa viteve kur është zhvilluar lufta 10- vjeçare ndërmjet Iranit dhe Irakut për një kufi të përcaktuar para 150- vjetëve.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BEREISHA – Ju faleminderit! Meqë nuk ka tjerë të interesuar për diskutim, përgaditemi për votim të Projektligjti në parim, lus regjin të përgatitet.

Votojomë tash:

Për 59

Kundër 0

Miratohet në parim Projektligji.

Ftoj deputetët për një pushim deri në orën 14.

Fillimi i seancës pas pauzës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Lus deputetët që t'i zënë vendet dhe vazhdojmë punën.

Në vazhdim e kemi pikën e 9- të rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin e gjuhëve

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 26.6.2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka konstatuar se Projektligji për përdorimin e gjuhëve në Kosovë ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka konstatuar se dispozitat e Projektligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka konstatuar se dispozitat e Projektligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kalojmë në miratimin e amendamenteve një nga një.

Amendamenti 1

Pa përkrahje nga Komisioni Funkcional.

Fjalën e kërkon deputetja Sanije Aliaj

DEPUTETJA SANIJE ALIAJ - Z. kryetar amendamentet e Projektligjit për gjuhët disa herë ka ardhur në Komision për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe kthim e në veçanti në këtë javë 2 herë, por për shkak të mosforumit dhe kemi arritur t'i shqyrtojmë amendamentet e Komisionit Funkcional dhe natyrisht Komisioni ka votuar për amendamentet e Komisionit funksional, kurse paraqitja e këtij Komisioni është gabim, për shkak se jemi marrë vesh dhe kemi votuar në Komision që amendamentet 1, 5 dhe 13 të shkojnë si amendamente të deputetit Mahir Jagcilar, të deputetit të Partisë Turke, prandaj këtu i kemi edhe anëtarët e tjerë të Komisionit. Ne kemi votuar vetëm për amendamentet e Komisionit Funkcional dhe kërkoj të respektohet.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Kalojmë në votim .Edhe një herë, i papërkrahur nga Komisioni Funkcional.

Fjalën e kërkon Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Z. kryetar. E ndjej të nevojshme ta jap një sqarim të shkurtër për vonesën e miratimit të këtij ligji në lexim të dytë, prandaj m'i lejoni disa minuta të raportoju lidhur me rrugën që e ka kaluar ky ligj deri në fazën e miratimit në Kuvend në lexim të dytë.

Projektligji për përdorimin e gjuhëve ka arritur në Kuvend më 18.5.2005, siç e cekët është miratuar në lexim të parë më 24.6.2005, d.m.th. më tepër se një vit. Komisioni Funkcional ka mbajtur dëgjim publik për këtë projektligj më 8.9.2005, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues të UNMIK-ut, OSBE-së, Zyra për Komunitete dhe përfaqësues të komuniteteve në Kuvend me ç' rast gjatë diskutimit janë paraqitur opinione të ndryshme. Në fazën e shqyrtimit në Komision janë mbajtur edhe disa mbledhje ku janë shqyrtuar vërejtjet e UNMIK-ut, të 18.8. dhe ndryshimeet dhe plotësimeet e vërejtjeve të UNMIK-ut të 30.9.2005, kështu që me konsensus është vendosur që ky projektligj të shtyhet për arsye se nevojitej kohë shtesë për shqyrtimin e mëtejme të tij.

Komisioni Funkcional më 10.11.2005 i ka bërë kërkesë Kryesisë së Kuvendit që t'i lejojë kohë shtesë me qëllim që amendamentet të përgatiten për miratimin e Projektligjit sa më mirë dhe ligji të jetë sa më funksional pa diskriminime dhe në harmoni me dokumentet ndërkombëtare. Kryesia e Kuvendit i është përgjigju kësaj kërkesë pozitivisht më 8.12.2005. Pas shqyrtimit të vërejtjeve shtesë të UNMIK-ut të 30.9. deputetët e Partisë Demokratike Turke të Kosovës kanë dorëzuar edhe 21 amendamente në Projektligjin që po e shqyrtojmë që janë regjistruar në shërbimin përkatës me nr. 02/961 të datës 9 janar 2006 dhe janë shqyrtuar nga ana e Komisionit të gjitha këto amendamente. Këtu janë përfshirë edhe amendamentet për të cilat deputetja Sanije Aliaj e tërhoqi pikën (b) të rekomandimit të Komisionit për Komunitete.

Më 11 janar 2006 Komisioni e ka përgatitur dhe ka dorëzuar në procedurë të mëtutjeshme raportin me rekomandime në Projektligjin për përdorimin e gjuhëve, Pas dorëzimit të këtij raporti Kryesia e Kuvendit ka nxjerr përfundimin nr. 02/1027/96 të datës 7.02.2006 me të cilin Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media e ka ngarkuar që në bashkëpunim me propozuesin e këtij projektligji, pra me Qeverinë e Kosovës, t'i harmonizojnë qëndrimet lidhur me Projektligjin në fjalë. Në ndërkohë, Divizioni për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit i OSBE-së më 21.6.2006 ka dhënë komentet e veta në Projektligjin që po e shqyrtojmë, të cilat janë shqyrtuar në Komision. Me shkresën nr. 02/2673 të datës 12.7.2006 të evidencuar në shërbimin përkatës me shenjën 2417 Qeveria e Kosovës ka propozuar 5 amendamente të veta në ligjin që po e shqyrtojmë.

Përfundimisht më 14.7.2006 Komisioni i shqyrtoi amendamentet e Qeverisë, që i miratoi me përjashtim të amendamentit 3, që e ka miratuar pjesërisht. Për shkak të miratimit të amendamenteve të Qeverisë është përgatitur raport plotësues i Komisionit më 14.7.2006. Ky raport është përfshirë në radhitjen e amendamenteve më 25.7.2006. Pas dorëzimit të raportit të Komisionit më 25.7.2006 është bërë radhitja përfundimtare e të gjitha amendamenteve, të atyre të Komisionit, të Qeverisë dhe të deputetve të Partisë Demokratike Turke të Kosovës të nënshkruara nga deputeti Mahir Jagcilar. Kështu që të mos habiteni, sepse me **sinopsis** janë evidencuar si amendamentet e Mahir Jagcilarit, por këto janë të deputetëve të Partisë që e drejton ai.

Ky është një raport përkitazi me rrugën që e ka kaluar ky projektligj deri në ditën e sotme. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit znj. Nekibe. Fjalën e ka deputeti Mahir Jagcilar.

DEPUTETI MAHIR JAGCILAR – Faleminderit z. kryetar, Vërtet znj. Kelmendi ka dhënë një kronologji të saktë për hapat që kanë kaluar deri më sot. Unë mendoj që edhe sot do të kalojmë këtë hap. Ligji për përdorimin e gjuhëve për komunitetet ka qenë edhe ka me qenë një pikë e rëndësishme, kështu që unë do të kaloj në amendamentin 1 dhe do të kërkoj përkrahje nga deputetët, sepse mendoj se amendamenti 1, vetëm jep një sqarim definicioni. Nuk prek diçka në esencë, por është shumë i rëndësishëm ,sepse emërohen gjuhët zyrtare- e dhe gjuha turke dhe boshnjake në përdorim. Unë kërkoj përkrahje për amendamentin e parë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit!. Kalojmë në votim.

Amendamenti nr. 1 i papërkrahur nga Komisioni FunkSIONAL.

Votojmë tash:

Për 11

Kundër 50

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 2 pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash:

Për 10

Kundër 54

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti nr. 3 me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash:

Për 46

Kundër 20

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4.

Fjalën e kërkon z. Mahir Jakcilar.

DEPUTETI MAHIR JAGCILAR – Unë po e tërheq amendamentin ,sepse është në amendamentin e Qeverisë së Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – D.m.th për amendamentin nr. 4 votohet për variantin (a).

Votojmë tash:

Për 51

Kundër 15

Kalon amendamentei.

Amendamenti nr. 5 pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash:

Për 12

Kundër 51

Nuk kalon amendamenti

Amendamenti 6.

Kërkon fjalën z. Mahir Jagcilar.

DEPUTETI MAHIR JAGCILAR – Edhe amendamentin nr. 6 i propozuar po e tërheq, sepse është në amendamentet e Komisionit FunkSIONAL ose në amendamentin e Qeverisë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Znj. Nekibe kërkojmë sqarim nga ju.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Z. kryetar Në nenin 3.3 përpara nuk e kemi përkrahur këtë amendament. Më vonë pas arritjes së amendamenteve nga ana e Qeverisë e kemi përkrahur këtë amendament, por pjesërisht, sepse lidhur me nenin 3 Qeveria ka dhënë dy propozime për riformulim për 3.3. dhe 3.4. 3.3 e kemi përkrahur, 3.4 është i Qeverisë. 3.3 –shin e kemi bërë si amendament të Komisionit dhe ju mbetet juve të votoni.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Mos krijoni konfuzion ju dy komisionet, ju lutem. Në tekstin që e kemi përpara është e vërtetë që janë 3 propozime, por të dyja që mbeten, sepse deputeti Jagcilar e tërhoqi variantin e vet, të dyja kanë referencë 3 + 3 shkurt e shqip janë dy varianta, një i Komisionit, një i Qeverisë për të njejtën materie. Mos thoni që përkrahëm diçka dhe hodhëm diçka, janë dy variante që janë për një pikë 3.3. Nekibe këtu nuk shkruan asgjë për 3.4, vetëm nëse e ka te shtëpia, kështu që varianti është i njejtë dhe ai që nuk e voton njërin normalisht që nuk e voton as tjetrin dhe nëse e voton njërin është votuar edhe tjetri. Kjo të jetë e qartë, të mos krijohen konfuzione të kota.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Amendamenti nr. 6 votohet për variantin (a)

Votojmë tash:

Për 19

Kundër 49

Nuk kalon amendamenti.

Varianti (b)

Votojmë tash:

Për 10

Kundër 57

Nuk kalon amendamenti.

Amendmaneti 7

Janë dy propozime, Qeveria e Kosovës e përkrahur nga Komisioni FunkSIONAL dhe deputeti Mahir Jagcilar.

Fjalën e kërkon deputeti Mahir Jakcilar.

DEPUTETI MAHIR JAKCILAR – Z kryetar për amendamentin nr. 6 vërtet në votuam, cili variant mbeti ,sepse kjo është esenciale.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ka mbetur varianti i ligjit.

MAHIR JAGCILAR – Nuk është e pranueshme ,sepse nuk ka qenë as nga ana e Qeverisë, d.m.th.kundërshtohet.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Votimin për ligj dhe nxjerrjen e ligjit e bën Kuvendi dhe e miraton.

Amendamenti 7

Që i kemi dy variante. Qeveria e Kosovës me përkrahjen nga Komisioni Funkcional.

Votojmë tash:

Për 35

Kundër 28

Kalon amendamenti.

Fjalën e kërkojnë Rifat Krasniq.

DEPUTETI RIFAT KRKASNIQ – Faleminderit z. kryetar. Unë ju falënderoj juve dhe i falënderoj 120 deputetë që janë këtu. Vetëm duhet të mendojmë se ne këtu kemi jetuar me qindra vjet dhe falënderoj Parlamentin, po humbni komb, po humbni gjuhë që janë folur me qindra vjet. Ne e kemi dashur këtë Parlament,jo që të humb një popull prej Kosovës. Unë falënderoj Parlamentin dhe ne nuk kemi më këtu vend. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Asnjë normë ligjore nuk e humb gjuhën tënde këtu dhe unë mendoj se nuk keni arsye të largoheni. Vazhdojmë.

Amendamenti 8

I përkrahur nga Komisioni Funkcional.

Votojmë tash:

Për 46

Kundër 17

Kalon amendamenti.

Amendamenti 9

Pa përkrahje nga Komisioni Funkcional.

Votojmë tash:

Për 8

Kundër 56

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 10

I përkrahur nga Komisioni FunkSIONAL.

Votojmë tash:

Për48

Kundër 7

Kalon amendamenti.

Amendamenti 11

I përkrahur nga Komisioni FunkSIONAL. Është propozim i z. Mahir Jagcilar.

Votojmë tash:

Për37

Kundër20

Kalon amendamenti.

Amendamenti 12

Me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL dhe i deputetit Jagcilar.

Votojmë tash:

Për 39

Kundër 17

Kalon amendamenti.

Amendamenti 13

I përkrahur nga Komisioni FunkSIONAL.

Votojmë tash:

Për46

Kundër11

Kalon amendamenti.

Amendamenti 14 me dy propozime.

I Komisionit FunkSIONAL varianti (a)

Votojmë tash:

Për45

Kundër17

Kalon amendamenti.

Varianti (b) është i pa objekt dhe nuk ka nevojë të votohet për te.

Amendamenti 15

Pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash:

Për 9

Kundër 51

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 16

Pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash:

Për9

Kundër53

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 17

Me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash:

Për 47

Kundër 12

Kalon amendamenti.

Amendamenti 18

Me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash:

Për 38

Kundër 17

Kalon amendamenti.

Amendamenti 19

Votojmë tash:

Për 48

Kundër12

Kalon amendamenti.

Amendamenti 20

Me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash:

Për 50

Kundër 11

Kalon amendamenti.

Amendamenti 21

Votojmë tash:

Për49.

Kundër10

Kalon amendamenti.

Amendamenti 22

Votojmë tash:

Për53.

Kundër 8

Kalon amendamenti.

Amendamenti 23

Me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash:

Për40

Kundër22
Kalon amendamenti.

Mazllom Kumnova e ka kërkuar fjalën.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA – Mendoj që neni 22 i këtij projektligji duhet të hiqet në tërësi, sepse e ka një kosto sipas disa shënimeve rreth 2 milion e 500.000 € dhe është i pamundshëm ta përballojë buxheti i arsimit në Kosovë, përveç se duhet të zbriten pagat e mësimdhënësve dhe a mund ta bëjmë këtë?. Për këtë çështje sa di unë si anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa kemi reaguar dhe kemi kërkuar që të hiqet ky nen, mirëpo si duket vërejtja jonë ka mbetur diku në zyrat e këtij Kuvendi.

E dyta. Ne e kemi Ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm dhe me këtë ligj që po zbatohet aktualisht është rregulluar çështja e planeve dhe e programeve mësimore. Sa e kuptoj unë me këtë nen kërkohet që të bëhet ndryshim duke shtuar edhe një lëndë mësimore edhe gjuhën e dytë zyrtare. Një ndërhyrje e tillë nuk mund të ndodhë në asnjë sistem të arsimit në të cilin dimensionet e planeve dhe programeve mësimore rregullohen me Ligjin themelor për arsim. Nëse e lejojmë këtë në të ardhmen një numër të konsiderueshëm të projektligjeve mund të propozohen lëndë të reja mësimore. Ky është absurd dhe nuk bën të tolerohet, prandaj për hirë të mbrojtjes së shkollës nga këto ndërhyrje të dhunshme. Për hirë të fëmijëve tanë kërkoj që ky nen jo vetëm të hiqet, por edhe më mirë shqip të shlyhet, besoj se e kam përkrahjen.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju lutem z. Kumnova. Për cilin nen e patët fjalën ju?.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA – Për nenin 22, që është i përfshirë në amendament, por është pika 3. Unë propozoj që të fshihet në tërësi.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Komisioni ka mbajtur mbledhjen e sot në pauzë dhe lidhur me nenin 22.1 ka një ndryshim dhe propozon që në vend të fjalës: “Çdo person do të mësojë gjuhën e dytë zyrtare” të shkruhet: “Mund të mësojë gjuhën e dytë zyrtare” që do të thotë se gjuha e dytë zyrtare mbetet fakultative, kush të dëshirojë le të kërkojë që ta mësojë, kush nuk dëshiron nuk mund t’i imponohet. Ky është propozim i Komisionit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA-Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Faleminderit z. kryetar. Mendoj se sot po e diskutojmë një ligj shumë të rëndësishëm duke pasur parasysh situatën në të cilën aktualisht ndodhemi. Është një ligj që bën pjesë në grupin e ligjeve të standardizimit dhe ne me një lehtësi shumë të madhe ju kemi qasur hartimit të tij sot dhe në një mënyrë me lehtësi shumë të madhe i përjashtuam disa kolegë tonë nga seanca, me **makinë votuese** dhe nuk po e marrim parasysh se ekzistojnë modele të ankimit që

këtë ligj mund të na kthejnë prapë në seancë. E përkrah z. Kumnova dhe e kam përkrahur edhe në Komision të Buxhetit. Ligji për përdorimin e gjuhëve nuk ka të bëjë me arsimin dhe nuk do të ishte dashur të ketë reperkursionë në arsim, sepse ky është ligj për përdorimin e gjuhëve zyrtare në administratë dhe si i tillë mendoj se propozimi i Mazllomit është shumë me vend. Pra, çështjet që kanë të bëjnë me mësimin e gjuhëve apo mosmësimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë duhet të rregullohen me Ligjin e arsimit dhe materia që duhet të përmbahet në atë planprogram mësimor duhet të jetë pjesë e nomenklaturave të arsimit e jo e këtij ligji që ka kryesisht të bëjë me administratën, prandaj duhet ta përkrahim propozimin e Mazllomit për nenin 22. Për pozicionet që më parë u mbivotuan, mendoj se do të duhej të merremi përsëri me to.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI. – Z. kryetar, të nderuar deputetë. Sa u përket gjuhëve zyrtare mendoj që janë përfillur standardet dhe ne e kemi ngritur standardin për përdorimin e gjuhëve të komuniteteve. Sa i përket çështjes që e shtroi z. Mazllom Kumnova edhe unë pajtohem që ai nen si i tillë të fshihet në tërësi.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naser Osmani.

DEPUTETI NASER OSMANI – Neni 22 është pikërisht ai që Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka detyruar që të bëjë rekomandimin që ligji paraqet implikime të jashtëzakonshme buxhetore. Nëse ky nen nuk fshihet që ishte dashur të fshihet, atëherë ligji do të mund të implementohet me një kosto më të lirë, kështu që buxheti i Kosovës mund ta përballojë. Jam plotësisht dakord që nëse pajtohen edhe kolegët, deputet e tjerë që neni 22 të fshihet dhe të mos riformulohet në forma të tjera.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e kërkon Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Z. kryetar edhe Komisioni ka sqaruar për ç' arsye e ka përkrahur deputetin Mahir Jagcilar dhe asgjë nuk ka kundër kësaj, sepse teksti ligjor përputhet plotësisht me tekstin e Ligjit për arsimimin fillor dhe të mesëm. Të dyja këto të nenit 22 nuk e di pse nuk po përkrahet kur kjo është tashmë atë ligj.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Fjalën e ka Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Unë dola të sqaroj se sigurisht është vapë e madhe dhe këtu ka paqartësi të mëdha. Ai amendament që e propozoi z. Kumnova që edhe disa të tjerë e përkrahën në rendin e amendamenteve që po i votojmë, nuk ekziston fare. Nëse është bërë i ri dhe duhet të thuhet se është amendament i ri që ta kenë të qartë deputetët se çka po bëjnë. Ai amendament nuk është në letrat që i kemi ne, por është një variant i ri të cilin e ka votuar Komisioni. Të jemi të qartë se nuk ekziston znj. Nekibe.

Ne kemi mbërri tek amendamenti 24 që implikon nenin 21.4 dhe jemi ndalur e po diskutojmë, ju lutem vetëm të sqarojmë, Unë nuk do të komentoj asgjë, as për as kundër, bëjuani të qartë deputetëve që kërkesa për heqje të nenit 22 është amendament i ri ,ju lutëm. Ju faleminderit!.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka z. Kumnova.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA – Shqip fola dhe po më duket se isha shumë i qartë, ne nga ana e Komisionit të Buxhetit i kemi dërguar Komisionit Funkcional që të fshihet ky nen. Ne këtë material e kemi marrë dje.Kam vërejtur se nuk është amendamenti i Komisionit të Buxhetit dhe Financave, Nuk është futur sot këtu, prandaj reagoj që neni 22 ndërhyt dhunshëm në ligjet themelore të arsimit, nuk e ka vendin. Pra, kërkoj të votohet që neni 22 të hiqet.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Profesor Hamiti e ka fjalën.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. Mazllom shqip po flet ,por po ngatërrohesh, problemi është që ne e kemi një dokument zyrtar për të cilin jemi duke votuar. Kemi mbërri te amendamenti 24. Ju flitni për nene të ligjit. Ne dokument të vlefshëm para këtyre sqarimeve e kemi këtë dhe nuk kemi tjetër. Pse po them kështu. sepse edhe materia që ti po e paraqet kontestohet me një amendament që është 25 ,i cili me gjithë atë merret me nenin 22 bile e përkrah. Keni kujdes ,unë po dua saktësi. Nëse neni 22, si kërkesë e re e komisionit hiqet, atëherë vetvetiu nuk duhet të votohet amendamenti 25 fare, po dua sqarim. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Fjalën e ka Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Më duket se isha e qartë Komisioni në pauzë u mblodh dhe e shqyrtoi edhe një herë nenin 22.1 dhe me konsensus mori qëndrim që ky amendament të pësojë ndryshime vetëm në fjalën “do të” e vendosi: “mund të mësohet gjuha e dytë zyrtare”, që do të thotë prej imperativit kalkoj në fakultativ. Ky është amendament i ri i Komisionit që sot u propozohet deputetëve.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Fjalën e ka deputeti Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Ne si grup parlamentar iu kemi qasur me seriozitetin më të madh kësaj çështjeje dhe mbështesim propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.Këtij propozimi i bashkangjiten z. Kumnova dhe Grupi Parlamentar i PDK-së dhe ju them që të na ftoni në votim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Për fjalë është paraqitur Besa Gaxherri

DEPUTETJA BESA GAXHERRI – Faleminderit z. kryetar, ndoshta mund të kontribuoj. Neni 22..3 ka amendamentin 25. Kuvendi sipas të gjithë diskutuesve po propozon amendament në vend të amendamentit 25 që neni 22.3 të fshihet, d.m.th se ne propozojmë të fshihet ky nen dhe kështu shkojmë tutje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Fjalën e ka Nafije Berisha.

DEPUTETJA NAFIJE BERISHA – Z. kryetar .Unë propozoj ta miratojmë apo të mos e miratojmë amendamentit 2, kurse në amendamentin 25 të shtohet opcioni i dytë i Komisionit për Buxhet. Kjo d.m.th i kemi dy propozime, Komisionin Funkcional për nenin 23.1 dhe Komisioni për Buxhet për fshirjen e nenit 22 në tërësi. Janë pra dy opsione .Sipas Komisionit për Buxhet ky është një lëshimi teknik dhe të merret si i tillë e të hyjë opioni i dytë i Komisionit për Buxhet që neni 22 të fshihet në tërësi.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka profesor Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Deputetë, kolegë të respektuar dhe pak të lodhur. Ne po bisedojmë për nenin 22 dhe është mirë që ta shohim materien se çka është ,sepse nëse flitet përmendësh është pak problem. Ju lutem dëgjoni me vëmendje se çka thotë neni 22 dhe të dëgjojmë dy variante që vijnë nga Komisioni, herë si tërësi, herë si eksponent të Komisionit.

Neni 22.1 thotë: “Në shkollat fillore në plotësim të gjuhës së mësimi çdo person do të mësojë gjuhën e dytë zyrtare”, kurse 22.2: “Në shkollat e mesme në plotësim të gjuhës së mësimi mundësohet mësimi i gjuhës së dytë zyrtare si pjesë e planprogramit opcional, nxënësit së bashku me prindërit e tyre kanë të drejtën për të zgjedhur mësimin e gjuhës së dytë zyrtare”, 22.3: “Planprogrami për mësimin e gjuhëve zyrtare zhvillohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”. Nga bisedat e derikëtushme që u përpoqa t’i dëgjoj me kujdesin më të madh kemi dy variante. Varianti i Nekibe Kelmendit, që do të thotë i Komisionit thotë: “Në shkollat fillore në plotësim të gjuhës së mësimi çdo person mund të mësojë gjuhën e dytë zyrtare”, në anën tjetër kemi një propozim që e jep z. Kumnova, i cili thotë: “Neni 22 të mos votohet i tëri, d.m.th.ne i kemi znj. Nekibe dy variante për votim. Nëse pajtohemi si Kuvend z. kryetar e nxjerr në votim njërin variant dhe tjetrin. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Znj. Nekibe, na jepni sqarime ju lutem për amendamentin 24.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Në amendamentin 24 si duket këtu ka diçka të thuhet, prandaj më jepni kohë që ta krahasoj me ligjin. Neni 21.4 komunat ku gjuha e zgjedhur zyrtare e personit nuk përdoret nga asnjë shkollë në mësim, do të përcaktohen dispozita përkatëse për të siguruar mësimin e duhur në gjuhën e tyre të zgjedhur zyrtare, hollësisht për implementimin përcaktohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Këtu nuk ka kurrfarë sugjerimi të Komisionit dhe mendoj se ky amendament nuk ka mesazh. Sigurisht është bërë ndonjë lëshim teknik dhe nuk mund të votohet kështu se është i mangët. Tërhiqet.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Fjalën e ka deputeti Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Faleminderit z. kryetar. Pra, shihet qartë se shqyrtimi dhe miratimi i këti ligji jsnë ngatërruar. Mendoj se në situata të tilla lëshimet janë të pashmangshme. Konsideroj se është e nevojshme t’i parandalojmë, sepse është edhe çështje shumë e ndjeshme me mundësi edhe të

keqpërdorimit, prandaj propozoj që të ndërpresim shqyrtimin e mëtejshëm të këtij projektligji që dy komisionet, Komisioni Funkcional dhe për shkak të ndërlikohjes së theksuar gjatë gjithë tekstit edhe Komisioni për Arsim dhe Kulturë të punojnë së bashku dhe të përgatisin versionin e harmonizuar, duke përfshirë edhe ndonjë nen ose amendament që u kalua. Mendoj që në këtë mënyrë do të parandalohet një situatë e ngatrruar në procedurë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Fjalën e ka deputeti Jakup Krasniqi.

DEPUTEETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, të nderuar deputetë. Unë nuk pajtohem me variantin që t'i hyjmë edhe një herë atë që e kemi votuar, por për variantin tjetër. Mendoj që është mirë të ndërpritet seanca, të harmonizohen nenet dhe nesër të vazhdojmë këtu ku po e lëmë sot.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – Z. kryetar mendoj se duhet qartësuar nenin 22 dhe kështu me biseda nuk mund ta qartësojmë, sepse të jepen 15 minuta pushim dhe Komisioni për Buxhet dhe Komisioni funksional të na japin variantin konkret. Ky është propozimi im.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Fjalën e ka Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Problemi është i qartë, amendamenti 24 mund të jetë gabim teknik i këtyre që i kanë radhitur amendamentet, sepse materia nuk korrespondon dhe këtë juristët që janë këtu, një grumbull njerëzish e dinë dhe ne nuk votojmë se nuk ka objekt për këtë nen, por kjo neve nuk na përjashton mundësinë të vazhdojmë me nenet e tjera. Ishim te ... 25 që llidhej me amendamentin 25 që lidhej me nenin 22 dhe i kemi dy propozime. Edhe unë propozoj që të vazhdojmë se nuk ka arsye për një gabim teknik të ngurrojmë të punojmë tutje. Kalojmë në amendamentin 25, në amendamentin e Komisionit që të hiqet neni 22, ju lutem shumë dy variante i kemi të vendosim. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka Xhulshen Berisha

DEPUTETJA XHULSHEN BERISHA – E kam fjalën për propozimin e Z. Mazllo m që është një propozim mjaft i qartë, kurse te propozimi i znj. Nekibe ku cakton fjalën: "mund" në ligj nuk mund të jetë mundet apo nuk mundet, sepse duhet të sanksionohet, prandaj mendoj se ky propozim i znj. Nekibe duhet të bie poshtë dhe përkrahi propozimin e z. Mazllo m.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Fjalën e ka Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Pasi m'u përmend emri po replikoj. Teknika e hartimit të ligjeve lejon mundësinë "mund" dhe "duhet" ose "do të".

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Kalojmë në votim të amendamentit 24.

Fjalën e kërkon Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Mundemi të votojmë për dy opsione, njërin siç e dha z. Mazllom Kunova dhe tjetrin siç e tha znj. Nekibe, të hyjnë dyjat në votim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ftoj deputetët që të votojmë për amendamentin 24 me përkrahjen e komisionit funksional.

Votojmë tash:

Për 13

Kundër 45

Nuk kalon amendamenti.

Kalojmë me propozimin e amendamentit të Mazllom Kumnovës.

A ka kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Me shumicë votash fshihet neni 22 i Ligjit.

Amendamenti 25

Është i pa objekt.

Amendamenti 26

Ka përkrahjen e Komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për 46

Kundër 15

Kalon amendamenti.

Amendamenti 27

Me përkrahjen e Komisionit Funksional.

Votojmë tash:

Për 42

Kundër 15

Akalon amendamenti.

Amendamenti 28

Me përkrahje të Komisionit Funksional.

Votojmë tash:

Për51

Kundër10

Kalon amendamenti.

Amendamenti 29

Votojmë tash:

Për55

Kundër 9

Kalon amendamenti.

Amendamenti 30

Fjalën e kërkon Nekibe Kelemendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI - Neni 29.1 duhet të qëndroj, është lëshim teknik, nuk përmendet pika 1, sepse fjala: "medijat publike" është zëvendësuar me fjalën "transmetues publik" për t' u harmonizuar me Ligjin për mediat ku quhet: "transmetues publik" e jo "media publike" duhet t'i shtohet 29.1

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Votojmë për amendamentin 30 me vërejtjet që i dha zonja Nekibe.

Votojmë tash:

Për53

Kundër 11

Kalon amendamenti.

Amendamenti 31

I kemi dy propozime. Komisioni Funkcional varianti (a)

Kalojmë në votim.

Për55

Kundër 9

Kalon amendamenti në variantin e parë.

Amendamenti 32

Me përkrahje të Komisionit Funkcional.

Votojmë tash:

Për 52

Kundër 7

Kalon amendamenti.

Amendamenti 33

Janë dy variante, i Komisionit Funkcional varianti (a)

Votojmë tash:

Për48

Kundër 12

Kalon amendamenti.

Amendamenti 34

Me përkrahje të Komisionit Funkcional.

Votojmë tash:

Për54

Kundër 8

Kalon amendamenti.

Amendamenti 35

Me përkrahje të Komisionit Funkcional.

Votojmë tash:

Për48

Kundër10

Kalon amendamenti.

Amendamenti 36

Me përkrahje të Komisionit Funksional.

Votojmë tash:

Për.....51

Kundër..... 9

Kalon amendamenti.

Amendamenti 37

I përkrahur nga Komisioni Funksional.

Votojmë tash:

Për53

Kundër.....9

Kalon amendamenti.

Amendamenti 38

Pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Votojmë tash:

Për.....7

Kundër.....57

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 39

Me përkrahje të Komisionit Funksional.

Votojm tash:

Për53

Kundër9

Kalon amendamenti.

Amendamenti 40

Me përkrahje të Komisionit Funksional.

Votojm tash:

Për49

Kundër12

Kalon amendamenti.

Amendamenti 41

Me përkrahjen e Komisionit Funksional.

Votojmë tash:

Për49

Kundër8

Kalon amendamenti.

Amendamenti 42

Me përkrahje të Komisionit Funksional.

Votojmë tash:

Për51

Kundër10

Kalon amendamenti.

Amendamenti 43

Me përkrahje të Komisionit Funkcioinal.

Votojmë tash:

Për53

Kundër10

Kalon amendamenti.

Fjalën e kërkon z. Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Faleminderit z. kryetar. Unë pak më parë e shtrova një propozim dhe prita që të hidhej në votim. Besoj se do të ishte mirë, me gjithë atë edhe tani kemi një rast për të parandaluar një situatë që do të mund të na kthehej bumerang. Propozoj që për këtë ligj bazuar edhe në rregullën që parashesh mundësinë e shqyrtimit të tretë të ligjeve në Kuvendin tonë edhe sipas praktikave parlamentare kur ka çështje të pasqyruara, praktikohet që të spastrohet teksti dhe pastaj të hidhet në votim. Mendoj që do të ishte mirë ta aplikojmë këtë instrument dhe ndërkohë t'i autorizojmë komisionet jo vetëm Komisionin për Shërbime Publike, por edhe Komisionin për Arsim dhe Kulturë që ta finalizojnë dhe ta spastrojnë tekstin që të mos humbim kohë pastaj me procedura të mëtejshme. Mendoj se fitojmë dhe nuk humbim, po e hedh si propozim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Faleminderit z. Hyseni. Ne kemi votuar për secilin amendament veç e veç dhe na mbetet ta miratojmë ligjin në tërësi me amendamente.

E hedh në votim. Kush është për?

Votojmë tash:

Për52

Kundër13

Konstatohet se aprovohet ligji për përdorimin e gjuhëve me amendamentet e votuara. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e 10 të rendit të ditës.

10 Shqyrtimi i propozimeve nga GP për emërimin e anëtarit të Këshillit të Përkohshëm për Mediat

Në pajtim me nenin 4.3 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media në transmetim nr. 02/15, **Kuvendi i Kosovës e emëron anëtarin vendor të Komisionit për Media.**

Në pajtim me procedurat për emërimin e anëtarit vendor në Këshillin për Media dhe në kërkesë të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës grupet parlamentare i kanë propozuar kandidatët dhe atë. Adil Pireva nga LDK-ja, Ekrem Kryeziu nga PDK-ja, Maksut Shehu nga Ora, Vjosa Shala – Pallaska nga AAK-ja.

Materialet me propozimet e grupeve parlamentare dhe me biografite e kandidatëve, u janë shpërndarë të gjithë deputetëve.

Meqë janë propozuar më shumë se një kandidat, emërimi i kandidatit duhet të bëhet me votim të fshehtë dhe kërkon shumicën e votave të deputetëve prezent.

Për mbarvajtjen e votimit do të përkujdeset Komisioni nga tre zyrtarë të Departamentit Ligjor nën monitorimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Propozoj që Komisioni t'ia fillojë punës.

Fjalën e kërkon z. Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI - Z. kryetar. duke pasur parasysh numrin e zvogëluar të deputetëve në sallë, unë kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për nesër.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Në sallë janë 53 deputetë.

Kolegë po ju them sinqerisht që kjo nuk është serioze.
Nuk kemi numër të mjaftueshëm të **deputeteve** për të votuar.

Vazhdojmë nesër në orën 10

Vazhdimi i seancës më datën 28 korrik 2006

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Kolegë deputetë mirë se keni ardhur, vazhdojmë seancën e djeshme. Kemi mbetur në pikën e 10- të të rendit të ditës- **Shqyrtimi i propozimeve nga G/P për emërimin e anëtarit të Këshillit të Përkohshëm për Media.**

Kemi këto propozime, Adil Pireva, Ekrem Kryeziu, Maksut Shehu dhe Vjosa Shala – Pallaska.

Zgjedhja e kandidatit duhet të bëhet me vota të fshehta, prandaj lus shërbimin që të përgatit materialin për votim.

Fjalën e ka deputeti Xhezair Murat.

POSLANIK DŽEZAIR MURATI – Poštovani predsedniče, g. ministri, kolege. Kad smo usvajali zakon o medijima, mi smo doneli ovde jedan amandman da u nezavisnoj komisiji za medije bude jedan član iz srpske zajednice i ta procedura je obavljena, takođe amandman bio da jedan član u nezavisnoj komisiji za medije bude iz redova ostalih zajednica, to je ušlo u zakon, odluka je doneta skupštinska i dokaza o tome ima u transkriptima, međutim na putu između Skupštine i pravne kancelarije specijalnog predstavnika negde je ta odluka isparila ili iz neobjašnjivih razloga nema implementacije te odluke, na jedan od nedavnih sastanaka članova Predsedništva i šefova grupa predsednik Kolj Beriša je rekao da je u komisiji izborom članice Milene time zastupljen kriterijum i polni i manjinski, dakle tu ne može biti preko Milene da bude član zastupljene zajednice, ja mislim da je tu jedna nepravedna odluka i mi smo kao parlamentarna grupa 6+ svo vreme u ovoj Skupštini vrlo principiëlno glasali za sve grupe od interesa građana na Kosovu, a najčešće za odluke koalicije čiji smo deo, međutim kada su u pitanju ostvarivanja prava manjinskih zajednica, prije svega mislim na bošnjačku i trursku, mi nemožemo prihvatiti ponekada odluke koje idu na uštrb naših prava, tako da nekada nećemo moći biti prisutni u djelu sednica kada se donose odluke koje idu na štetu naših interesa. Ja vrlo ozbilno ovde navodim, treba razmotriti, treba videti, treba imati više sluha, pogotovu kada naši zahtevi ne idu na uštrb niti interesa Kosova, niti većinske zajednice. U onom djelu gdje se uskraćuju naša prav, mi tom djelu sednice nećemo moći uvijek prisustvovati. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në njërin nga seancat e kaluara është dhënë sqarimi për këtë z. Xhezair. Kemi edhe preferimin e Zyrës Ligjore që është plotësuar ai kusht, janë dhënë të gjitha sqarimet dhe nuk ka kurrfarë pengese për votimin për kandidatë për të cilët folëm më parë. Ju personalisht, si grup i juaj nuk keni dhënë propozim tjetër. E keni ditur afatin e caktuar për të dhënë propozimet.

POSLANIK DŽEZAIR MURATI- Predsedniče na zajedničkoj sednici članova Predsedništva i šefova grupa Vi ste doslovce rekli da je izborom člana o kojom sam govorio ispunjen taj rok i onda niste nam ostavili mjesta da mi naknadno dopunimo član, takvim stavom i takvom odlukom i u tom slučaju ne vidim svrhu prisustva odluci o kojoj se govori.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Edhe tash po them se është plotësuar ai kusht, jo që po e them unë, por e kanë thënë organet edhe më kompetente se unë, por pasi keni dashur të propozoni kandidat tjetër është dashur të propozoni tash. Megjithatë do të kalojmë në votim.

Për mbarvajtjen e votimit do të përkujdeset Komisioni nga 3 zyrtarë të Departamentit Ligjor, nën monitorimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Ftoj deputetët një nga një të votojnë Votohet për një kandidat që e keni në listë:

Afrim Arzuallgjiu, përgatiten Agim Krasniqi, Ali Sadriu dhe Alush Gashi, Bajram Kosumi, Bajram Rexhepi. Mungojnë: Bajrush Xhemajli, Behxhet Brajshori, Berat Luzha, Besa Gagjerri. Besa mungon, Mungojnë po ashtu : Bislim Hoti, Brikena Kryeziu, Bujar Dugolli, Demir Limaj,, Dragisha Krstoviq, Drita Statovci, Xhezair Murat,, Emin Krasniqi, Emrush Xhemajli, Enver Hoxha, Ethem Çeku, Fadil Gashi, Fadil Geci, Fadil Kryeziu, Fatmir Rexhepi, Fatmire Mulhaxha – Kollçaku, Fehmi Mujota, Fehmi Vula, Ferid Agani, Fetah Berisha, Flora Brovina, Gani Koci Gazmend Muhaxheri , Genc Gorani, Gojko Saviq, Goran Bogdanodviq m Gjergj Dedaj, Gjylshene Berisha, Gjylnaze Syla, Hajredin Hyseni, Hajredin Thaqi, Hashim Thaqi , Hatixhe Hoxha, Husnija Beshkoviq Hydajet Hyseni – Kaloshi, Ibush Jonuzi, Ilaz Pireva, Ilmi Ahmeti, Jakuip Krasniqi, Jonuz Kastrati, Jusuf Sutaj, Kamber Kamberi, Lulzim Zeneli, Lumnije Hyseni, Lutfi Zharku, Mahir Jagcilar , Mark Krasniqi, Mazllom Kumnova, Melihate Termkolli, Milazim Haliti, Myrvete Dreshaj – Baliu , Nafije Berisha, Naim Jerliu, Nait Hasani, Naim Maloku, Nait Hasani, Nagjije Doçi, Nazim Jashari, Nekibe Kelmendi, Nergjivane Dauti, Nexhat Daci , Nexhat Rexha, Nimon Alimusaj, Numan Baliq, Nuran Malta , Nurishahe Hulaj, Oliver Ivanoviq, Qibrije Hoxha, Ragip Zekolli, Ramadan Kelmendi, Ramadan Musliu, Ramë Buja , Rangjell Nojkiq Remzije Nimani, Rifat Krasniq , Rudina Bukoshi, Rrustem Ibishi , Sabit Rrahmani, Sabri Hamiti, Sadudin Berisha, Safete Haderxhonaj , Sala Ahmetaj, Sala Shala, Sanije Zeqiraj , Sanije Aliaj, Sasha Gjokiq ,Selvije Halimi, Sokol Bashota , Shaban Halimi, Shpresa Murati, Teuta Hadri, Teuta Sahatqija, Veton Surroi, Xhavit Haliti, Xhelal Canziba, Xhevat Bislimi, Xhevdeet Neziraj, Ylber Hysa, Ymer

Muhaxheri, Zahrije Jusufi , Zef Morina, Zllatica Kujungjiq , Zyhrrije Maloku, Zylfi Merxha, Zylfi Hundozi dhe Kolë Berisha.

Ftoj Komisionin që së bashku me grupet parlamentare t'i numërojnë rezultatet.

Raport i punës së Komisionit për rezultatet e votimit për emërimin e anëtarit në Këshillin e Përkohshëm për Media. Në mbështetje të kreut 9 pika 1.26C të Kornizës Kushtetuese dhe të Rregullës 31.3 të Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës, Komisioni votues në përbërje të Defrim Krasniqit, kryetar, Xheladin Hoxha, anëtar dhe Natasha Prica, anëtare, për zgjedhjen dhe emërimin e anëtarit të Këshillit të Përkohshëm për Media me votim të fshehtë nga deputetë e Kuvendit të Kosovës në seancën plenare të mbajtur më 28 korrik 2006 pas numrimit të votave konstatoi si vijon: Në votim kanë marrë pjesë 79 deputetë. Për Adil Pirevën kanë votuar 42, për Ekkrem Kryeziun kanë votuar 23, për Maksut Shehun kanë votuar 4 deputetë dhe për Vjosa Shala-Pallaska kanë votuar 7 deputetë. Të pavlefshme janë 3 fletëvotime.

Në bazë të rezultateve të votimit në pajtim me Rregullën 31.3 të Rregullores së punës së Kuvendit konstatohet se Adil Pireva është zgjedhur dhe emëruar anëtar i Këshillit të Përkohshëm të Mediave.

Kalojmë në pikën e 11 të rendit të ditës.

11. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e kryesuesist të Bordit të Rregullatorit të Energjisë.

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit për rregullatorin e energjisë nr. 2004/9 Qeveria e Kosovës i ka propozuar Kuvendit të marrë vendim për emërimin e kryesuesit të bordit për rregullatorin e energjisë dhe atë: Kandidatin Ali Hamiti. Propozimvendimi i Qeverisë së bashku me arsyetimin dhe biografinë e kandidatit të propozuar u është shpërndarë të gjithë deputetëve me kohë. A ka nevojë sqarime nga ana e ministrit? Nuk ka. Kalojmë në votim elektronik.

Fjalën e kërkon Hatixhe Hoxha.

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA – Zoti kryetar, të nderuar deputetë. Ne përshëndesim kalimin e kompetencave, mbi bafazën e ligjit, nga ndërkombëtarët te vendorët.

Ndërsa sa i përket emërimit të udhëheqësit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, më lejoni të shprehë qëndrimin e Grupit Parlamentar të PDK-së.

Ne si Grup Parlamentar, kemi vërejtje në udhëheqjen e z. Ali Hamitit, gjatë kohës sa ishte kryetar i Bordit të KEK-ut.

Prandaj, si Grup Parlamentar ne do të abstenojmë, gjatë procesit të votimit, ndërsa në të ardhmen do të përcjellim punën e këtij rregullatori dhe më pas do të shprehim vlerësimet tona. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit!

Kalojmë në votim dhe votojmë tash:

Për50
Kundër10

Pranohet kandidati Ali Hamiti. Ju faleminderit!

12. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e zëvendësministrit të Drejtësisë, Altay Surroi.

Në mbështetje të Rregullore së UNMIK-ut nr. 2001/19 Qeveria e Kosovës i propozon Kuvendit të marrë vendim për emërimin e zëvendësministrit të Drejtësisë z. Altay Surroi. Propozimi i Qeverisë së bashku me arsyetimin dhe biografinë e kandidatit të propozuar u është shpërndarë të gjithë deputetëve me kohë.

Kalojmë në votim.

Fjalën e kërkon Hajredin Kuçi.

DEPUTETEI HAJREDIN KUÇI – Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë, mendoj që propozimi është krejt okej, por besoj që në kohën kur bëhen ndryshime apo propozime në Qeveri duhet të jetë kryeministri prezent, apo në rastin më të vogël duhet të jetë ministri i Drejtësisë i cili është përcaktuar për kandidatin që duhet të jetë zëvendës i tij. Sido që të jetë unë nuk jam kundërkandidaturës së tij, por në rastet e tjera duhet të jetë praktikë e mirë që të emëruar për Qeveri të jenë njerëzit që e arsyetojnë atë propozim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Këtu e kemi zëvendësin tjetër të ministrit të Drejtësisë.

Kalojmë në votim.

Votojmë tash:

Për34
Kundër32.

Kalon kandidati.

Konstatoj se Kuvendi me shumicë votash miratoi emërimin e z. Altay Surroi për zëvendësministër të Drejtësisë.

Me kaq seanca i përfundon punimet.

Pushimet për deputetët fillojnë nga 25 korriku deri më 25 gusht dhe do ta kemi obligim që në fund të muajit gusht ta mbajmë një seancë ,nëse është e nevojshme.

Ju dëshiroj pushim të këndshëm!.